

# Oral History Kosovo

---

## INTERVISTË ME MUHARREM MUSLIUN

Prishtinë | Data: 27 Tetor, 2023

Kohëzgjatja: 173 minuta

Të pranishëm:

- Muharrem Musliu (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zotëri Muharrem nëse mundeni me u prezantu, vitin e lindjes, me na tregu diçka për kujtimet e para t'jujat?

**Muharrem Musliu:** Po, unë jam Muharrem Musliu. Kam lindë në fshatin Marec komuna e Prishtinës, nja 30 kilometra larg qytetit. Katuni ma i madh me hapësirë në trojet shqiptare. Prej ni familjar t'varfur. Mirëpo shkaku i varfnisë e kto më 1943 jemi shpërngulë në Prishtinë. Faktikisht në Lagjen Pozerka, si thojnë te Xhamia e Llapit, atje. Domethanun për Marec pak di, se shkaku që kam dalë shumë i ri. Mirëpo për Prishtinë di bukur shumë, meqë jam rritë, jam shkollue edhe ende jetoj në Prishtinë.

Si fmi në Pozerkë aty kemi pasë ni fmijëri jo t'mirë. Meqë n'atë kohë gjuha e kohës ishte gjuha turke edhe neve pak na, edhe na, na injorojshin t'u na thanë çili që i bjen shqip katunar. Deri në moshën pesë-gjashtë vjet veç n'lagje, s'kemi guxu me dalë jashtë lagjës tonë. Mirëpo kur i bam kah shtatë-tetë vjet edhe na familja jonë ishim katër motrat edhe atëherë dy vllazën, e msum turqishtën për katër-pesë vjet (qeshë). Dashtë e pa dashtë e msum turqishten. Në vitin 1947 u regjistrova në klasë të parë në Shkollën Alaudin. Osht' te xhamia afër Dodonës...

**Anita Susuri:** Si Medrese.

**Muharrem Musliu:** Si Medrese, jo shkollë kshtu po qashtu ka qenë. E msusen e parë e kom pasë Muzafere Hatipin. Domethonë vitin e parë edhe të dytë filllore e kom kry në Alaudin. Masanej kemi pushue ktu në përgjithësi gjysma e t'rive Prishtinës nja dy vite kemi pushue s'kemi shku nëpër shkolla. Meqë nuk ka pasë lokal. Me 1951 u hap Shkolla Emin Duraku në Pozerkë edhe klasën e tretë dhe të katërten e kom krye te msusi Vesel Pagarusha, babai i Nexhmie Pagarushës. Ni prej këngëtarëve tona ma t'mira.

E kreu edhe filloren, atëherë u regjistrova në Gjimnaz të Prishtinës quhej Ivo Lola Ribar. Se në atë kohë ishte gjimnazi i ulët dhe gjimnazi i lartë, i naltë i thojshim. Gjimnazin e ultë aty. Rregullisht shkojshim nja 15-20 vet të lagjes tonë në gjimnaz aty. Masanej e kreu tetë vjeçaren ose gjimnazin e ulët, u regjistrova në gjimnazin e naltë. Aty e kreu me 1960-'61. Po peripetitë tona kanë qenë, janë edhe të papërshtueshme. Gjendja ekonomike masanej gjendja politike.

Mirëpo gjendja ekonomike ndoshta disi ka kalue po gjendja ekonomike nuk ka qenë n'rregull. Sepse neve na shiqojshin pak ma ndryshe, çka ishim t'katunit. I kanë pasë informatat të gjithë se prindërit tonë çfarë partie politike kanë qenë. Unë axhën e kom pasë në Partinë NDSH<sup>1</sup>. Dajtë i kom pasë gjithashtu të Dabishevcit. Nipat e Mramorit gjithashtu NDSH-ista. Domethonë jom rritë në frymën e NDSH-së. Në gjimnaz kemi pasë peripeti.

Osht' interesant ndoshta për gjenerata me tregue, tetë vjeçare kemi pasë landë në përgjithësi shqip sepse kemi pasë profesor prej Shqipërie. Ka qenë Zekerija Rexha, ka qenë Sali Kolgeci, kemi pasë Hajdar Jakupin. Kemi pasë profesor të nivelit t'naltë. Mirëpo në gjimnaz kur u regjistrova, veç dy landë i kemi pasë në gjuhën shqipe. Histori na jipte ni qytetar ktu, Shariq Qehaja edhe shqip Ramiz Hoxha. Në përgjithësi i kemi pasë landtë në gjuhë serbe.

Osht' interesant me tregu ndoshta për gjenerata që shpesh ndoshta nuk mundeni m'i kuptue, 46 jemi regjistru në vitin e parë, 16 e kemi krye gjimnazin. Sot kemi mbetë vetëm katër vet. E kemi kry 16 sepse të gjithë të tjerët i kanë largue për ni fjalë goje. M'kujtohet jashtëzakonisht mirë, e kreu tetë vjeçaren shkova m'u regjistru në gjimnaz ni Vlasta Nikoliç, ni profesor ish latinisht që jepte, ni shoviniste ekstreme. Kur i pytke, "Pse ke ardhë?" Nxënësit, ata nuk dishin me thanë që kom ardhë m'u regjistru serbisht. "Nuk je ti për shkollë".

Shkova une m'pa që po e di serbishten, meqë isha rritë në Prishtinë. Tha, "Për ty s'ka problem hiç". Merre me mend... se i kishim dy landë matematikë, shqip, tri landë edhe serbisht. Nuk më pytën hiç m'pranun (qeshë). Vetëm shkaku që disha gjuhën serbe. Çashtja politike duhet me fillue prej kohës që e mbaj mend. Sidomos prej '47 e këndeje ka qenë kohë e burgosjeve, kohë e malltetimeve, kohë e pa kohë. Nuk dihej kënd p'e marrin, nuk dihej kënd s'pe marrin.

Meqë dajtë unë i kisha n'burg. Daja Alush ka qenë përcjellës i Xhon Sereçit në Shipashnicë anena me gjithë ni Muharrem Pograhën. Tash ia kanë qit' ni pllakadë atje në Shipashnicë. Masanej nipat e mi Sylën edhe Sadikun këndeje në Mramor kur kanë dalë në Gollak Xhon Sereçi sigurisht të gjitha gjeneratat e vjetra, Xhon Sereçin e kanë pasë idol. Nipi im e ka përcjellë. Masanej diheshin për afërsisht se çfarë familje i përkisnim. Mirëpo unë ia fillova edhe sportit, pak më ka nxjerrë sporti për kto gjana që ma vonë sigurisht do të tregoj për sport çka m'ka ndihmu sporti politikisht, jo vetëm ekonomikisht po edhe politikisht...

**Anita Susuri:** Po du, po du me ju pytë pak edhe për kta familjarët që i përmende që kanë qenë në NDSH, a dini diçka, sigurisht e dini për fatin e tyre, si kanë përfundu? A janë përndjekë a po? Tregut në burg që kanë qenë dajtë.

<sup>1</sup> Lëvizja Nationale Demokratike Shqiptare, e njohur me inicialet e saj si LNDSH ose NDSH, u bë një rezistencë thuajse totale antikomuniste në Kosovë ndërmjet viteve 1945 dhe 1947.

**Muharrem Musliu:** Dajën Zenel edhe dajën Hasim m'i kanë vra në 1943-ten në mbrojtje të kufinit. Daja Alush ka qenë në përcjellje të Xhon Sereçit me 1947 e kanë burgosë bashkë me Xhon Sereçin edhe Muharrem Pograxhën. I kanë dënu ktu në Gjimnaz të Prishtinës, në sallë të Gjimnazit të Prishtinës, Ali Shukriu. Haptas po e thom Ali Shukriu se dihet. Xhon Sereçin e Ajet Gërgurin e kta i pushkatojnë, dajën tim e dënojnë shtatë vite burg edhe Muharrem Pograxhën.

Ndërsa kta nipat tjerë të Mramorit, Sylën e vrasin, gruen ia burgosin edhe osht' interesant për juve me tregue në Burg të Prishtinës, afër muzeut aty në qytet aty ka qenë burgu. Ka lind gruja e nipit tim dhe shoktë e burgut që kanë qenë kanë dashtë me ia lanë emrin Zullum. Zullum osht' fjalë turke, dihet çka i bjen. A din çfarë...

**Anita Susuri:** Problem.

**Muharrem Musliu:** Problemi ka qenë, e ia kanë lanë Zamon. Zamon osht' kohë, ma turqisht. Ai ka vdekë sivjet, Zamoni.

**Anita Susuri:** Ka lind në burg domethonë?

**Muharrem Musliu:** Ka lind në burg, gjashtë javë ditë ka lind në burg. Mirëpo e ka njoftë krejt si Zamon, unë meqë punojsha në ish Shërbimin e Kontabilitetit Shoqëror, tani në Bankë Qendrore të Kosovës e mora aty n'punë. Ka punu derisa ka dalë në pension. I ka tetë fmi i ka të gjithë të shkollun edhe kshtu. Domethonë familjet NDSH janë ndjekë. Qe ni shembull po ju tregoj, paska qenë te ju [Shazije Gërguri](#), vajza e Ajet Gërgurit. Bashkëshorti i saj, se sigurisht nuk ju ka tregue Shazija, Beqit Hasangjekaj e ka krye Fakultetin e Edukatës Fizike në Beograd.

Ai ka lujt hendboll, ka lujt për Partizanin e Beogradit. Ka qenë një prej hendbollistëve ma t'mirë që ka pasë n'atë kohë. Mirëpo si kanë marrë vesh që osht' feju me çikën e Ajet Gërgurit e kanë largue. Se u dashtë Beqir Hasangjekaj ktu dhe Shazija ktu. Si kanë marrë vesh me kënd është fejue e kanë largu meniherë prej sportit edhe prej Partizanit. Domethonë kta nuk i kanë lanë rastit kurgjo s'i kanë lanë rastit hiç, hiç kurgjo s'i kanë lanë rastit. Po kshtu kjo jeta...

**Anita Susuri:** Po m'intereson edhe diçka që përmendet që i kanë vra, a dihet për varret e tyre, familjarëve t'juj?

**Muharrem Musliu:** Po, Sylën po se e kanë vra në Mramor në prit e kanë vra. Na e kishim, ai kish pasë qenë në Marec e kanë majtë familja ime se prindi im, djali im djalë t'motrës. Mirëpo vritet në Mramor në prit osht' vra. Janë rivorros mas luftës janë rivorros, dihen, dihen. Daja Alush ky që ka qenë përcjellës i Xhon Sereçit ka vdekë me 1984-ten ktu në Prishtinë e ka familjen. Edhe unë për veti nuk kom qenë anëtarë i kurfar' partie kurrë n'jetë as i Lidhjes së Komunistëve që m'kanë propozue në shkollë, në gjimnaz s'kom pranue.

M'kanë propozue në Shërbim të Kontabilitetit Shoqëror kur kom punue ktu në Prishtinë, nuk kom pranue. Kom thanë, "S'jom i aftë". M'kanë propozu edhe në ushtri edhe atje s'kom pranue. Se ideologjia ime ka qenë kah NDSH-ja, ka prindërit edhe nipat. Mirëpo NDSH-ja me 1957 u burgosën ndsheistat e parë ktu në Prishtinë në krye me Rexhep Avdullahun, Vllezërit Novokas, Islam Mumxhiun, ni futbollist prej futbollistëve ma t'mirë. Shemsi Perani, Vebi Ruva, ka qenë milic n'atë kohë, po edhe ai. Dënohen... Kadri Deva, harrova me thanë.

Në klasë tonë në gjimnaz e kanë burgosë Kadri Devën, profesor i matematikës i Mitrovicës. Besoni tash po m'tërqethet trupi, kur erdhën, hyn disa, si m'i qujtë sot n'atë gjuhën bandida. Veç t'u shiku e kanë kap e kanë lidhë në klasë, në Gjimnaz të Prishtinës Kadri Devën. Në '57-ten e morën. I kanë dënu me dënime shumë t'rana. Ajo ka qenë ni burgosje me të vërtetë e jashtëzakonshme. Çka osht' edhe interesant në përgjithësi në 90% të tyre kanë folë nëpër shpija turqisht. Mirëpo shqiptarë me zemër, me shpirt edhe me trup. Ka qenë gjuhë e kohës. Gjuhë e kohës n'atë kohë.

**Anita Susuri:** Tash po m'intereson...

**Muharrem Musliu:** Mas... veç edhe diçka.

**Anita Susuri:** Po.

**Muharrem Musliu:** 1956-ten ke aksioni i armëve. Për aksion të armëve me ju tregu duhet nashta jo me muj po me vite. Ajo ka qenë diçka që rrallë përsëritet në botë rrallë përsëritet. Unë isha atëherë 16 vjeçar, kthehesha natën ose pa marrë parasysht kah Shkolla Emin Duraku në Pozerkë. I dëgjojsa njerëzit t'u bërtitë, t'u piskat prej rrafjeve, prej mundimeve. Ka qenë ni Zenun kryepolic, Zenun Avdija i Junikut. Ka qenë ni mostrom, mostrom ka qenë. Ai me qëllime t'caktune ka marrë Pozerka.

Pozerka po dihet kah, prej Xhamisë së Llapit e deri te Hani i Dilit atje që i thojnë. Se në përgjithësi kanë qenë t'katunit aty patën ardhë. Se ishte Tophanja, ishte Lagja Çekliku, ishte Lagja Divanjolli, ishte Lagja Maravska që i thoshin. Në përgjithësi që ishin qytetar. Ndërsa në Pozerkë erdhën ma së shumti prej katuneve. Ai e mori. Ni rast osht' keramika ku osht' aty që i thoshim Cigllana. Ni mëngjes u çova me shkue në shkollë kur p'e shoh kah Xhamia e Llapit do fmi po tubohen, po shkojnë.

Tash merre me mend ni e kish pasë var vetëvetën. Në aksion të armëve ni i Mramorit nifar' Xhemshiti, Xhemshit Gashi, s'ia kom harru emrin ende se e kom njoftë, e kish pasë var vetën prej mundimeve t'mdha edhe që mos me dorëzu armë apo kumeditë e kish var vetëvetën. Nuk e kanë hjekë deri kah ora 10:00-11:00. E kanë lanë me qëllime t'caktune që me pa, me pa populli që thojshin mileti me pa, populli.

Masanej në vitin 1957 filloj shpërngulja për Turki. Kjo osht' sikur vitit 1999 kur na përzun prej ktuhit. Përafërsisht e njejta. Kemi pasë kojshi aty nja tre vllazën Jalivali quheshin edhe turqisht folshin në shtëpi. Po vijnë po i thojnë dy ditë përpara babës tim, "Axha Rrahmon, nuk e lshojmë na Prishtinë kurrë hiç, hiç s'e lshojmë". Mas dy dite n'mëngjes kanë trokit n'derë kanë thanë, "Axha Rrahmon na kanë ardhë kanë thanë a p'e lshoni a ju pushkatum, ikëm. Po shkojmë për Shkup edhe prej Shkupit për Turki". Deri në vitin '64. Mirëpo '57, '58, '59 ka qenë Prishtina sikur viteve '99.

Mirëpo Prishtina në atë kohë ka qenë shumë ma e vogël dhe çka osht' ma kryesorja jemi njoftë. Jemi njoftë të gjithë mes veti. E kemi ditë cila familje metet, cila po shkon e cila s'po shkon. Vishin te dera, sikur '99-ten. 'Pse s'po shkoni për Turki? Pse s'po shkoni? Ju nuk jeni shqiptarë, ju jeni turqi'. Qashtu na thonin gjithmonë, 'Pse s'po shkoni?' Ai ka qenë ni tmerr që ata që kanë përjetu '99-ten mujnë me kuptu çka ka qenë ajo. Me familje, me krejt i lejshin aty edhe shkojshin.

**Anita Susuri:** A po ju kujtohet pastaj te kta kojshitë kush ka ardhë me jetu në shtëpitë e tyre? A e kanë shitë a çka kanë bo?

**Muharrem Musliu:** Në përgjithësi asni shitë ktu nuk janë në Prishtinë, kanë ardhë serbët. Bash afër nesh, afër te qata Janjevalit erdh nifar' Stana. M'kujtohet Stana. Nuk tregonte prej kuhit ka ardhë, nuk tregojshin për kuhit kanë ardhë. Po osht' interesant, ata mendojshin, jo mendojshin po mundoheshin m'u sjellë pak ma mirë, jo sikur vendasit ktu. M'u sjellë pak ma mirë. A din pse? Prej frikës, prej frikës e kanë pasë. Se në përgjithësi ishim shqiptarë. Aty në Pozerkë kanë qenë nja gjashtë-shtatë shtëpi kanë qenë serbe, s'ka pasë ma shumë.

Domethonë çdo lagje ka pasë kah gjashtë- shtatë shtëpi, shtatë-tetë shtëpi serbe. S'ka pasë ma tepër. Por n'vitin 1960, '61, '62 fillun me ardhë prej Serbije. Rast ndoshta osht' për t'u treguar. E kreu gjimnazin me 1961, konkurova në Shërbim të Kontabilitetit ktu Shoqëror edhe mua m'pranuan si sportist. Meqë luajsha futboll me ni ekip ktu të Grafiqarit të Rilindjes, Shërbimi i Kontabilitetit e kishte ni ekip të futbollit e tash t'u mendu se unë do t'shkoj do t'luj për ta, po osht' rast që po du me tregue, jemi pranu 26 vet me 1961.

25 kanë qenë të Nishit, të Prokuples edhe të Kurshumlisë, i vetmi unë kom qenë i Prishtinës ose i Kosovës. I vetmi dhe më kanë pranu si sportist. Kom punu me ni zyre ku kanë qenë 25 serb, serb në përgjithësi, i vetmi unë kom qenë shqiptar (qeshë). Kjo osht', kjo osht' e pabesueshme po është e vërtetë. Sot i di me emra, me mbiemra se e kom dhanë disa herë kur ka pasë nevojë, kush janë pranue të Nishit, të Prokuples, të Kurshumlisë. Veli Planës ka pasë, ka pasë të Pirotit, ka pasë prej Serbie. Erdhën ktu.

Masanej unë n'atë kohë luajsha futboll për Grafiqarin e Prishtinës, tani u bo Kosova. Në Prishtinë erdhën krejt lojtarët prej Malit të Zi, prej Serbisë metën... Islam Mumxhiu ma ishte n'burg. Mbet vetëm ni Karabegu, Ferat Karabegu. Ai e llogaritke vetën si turk edhe ka vdekë si turk.

**Anita Susuri:** Po du pak me folë edhe për prindërit e juj me çka janë marrë? Baba? Për familjen, rrethin?

**Muharrem Musliu:** Baba im... axha, se ishim bashkë me axhën ktu, baba im hyni në Ramiz Sadik si rojtar. Ramiz Sadiku ka qenë për ndërtimtari, si rojtar. Mirëpo ka qenë bukur i smutë, e ka pasë ithatin në bark. Ai relativisht i ri ka vdekë, 1967-ten, në moshën 57 vjeçare. Ka qenë njeri i punës, njeri që është mundu me mish e me shpirt me na shkollue, me na rritë, me na shkollue. Nanën e kom pasë të Dabishevcit, ajo ka qenë krejt shoktë thojnë, ka qenë diçka sikur të gjitha, si nana e Ismajl Dumoshit ose e Jusufit, nana Ajshe e shumë nana tjera.

Ajo ka qenë e pathyeshme. Nana ime është ajo me nifar' sargije që ka udhëheq demonstratat prej '81-shit e '99-ten me dy gishta. Osht' ni e shkurt. Ajo ka qenë edhe i ka... kur kanë shku gratë prej ktuhit që m'u nisë për Drenicë (qeshë), ajo ka qenë udhëheqëse. Këtë Flora Brovinën kur e kanë kap policia ktu te Pallati i Sporteve, ajo e ka nxjerrë prej dore, ua ka nxjerrë. Masanej në Institutin Albanologjik kur e morën ajo ka qenë aty me gjithë motrën time t'madhen dhe i kanë rreh bukur shumë. Ka vdekë më 2008 në moshën 102 vjeçare. Kshtu. Familja jonë, jemi rritë në relativisht t'varfur.

Mirëpo të gjithë qita të 1964 që kanë qenë nëpër burgje, 1968, 1975 kanë qenë, kanë kalu nëpër shtëpi timen, kanë hangër bukë në shtëpi time, kanë nejtë në shtëpi time. Kemi qenë shokë, kemi mbetë shokë me të gjithë qita. Mirëpo në përgjithësi shoktë ma të ngushtë t'mit e kanë kry këtë botë, janë n'atë botën tjetër. Sot takohem prap, prap takohem me qita shokë që i kom pasë qe 60 vjet e tepër

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Po më intereson nëse mundeni pak me na përshkru Prishtinën? Na tregut që ka qenë ni pazar përpara, kanë qenë do vende që ma nuk ekzistojnë sot, a i kujtoni kto?

**Muharrem Musliu:** Po si s'më kujtohen (qeshë), meqë jom rritë ktu. Ka qenë ni treg i vogël, ka qenë qitu stadioni i vogël ku osht' qitu kjo Hortikultura qaty ka qenë. Ni treg i vogël aty. Që zakonisht vishin. Se prej Kinemasë Rinia që osht' ktu edhe ku osht' shtëpiat e fundit ku osht' Grandi e krejt kto krejt kanë qenë bahçe. Sot na qitu ku jemi bahçe kanë qenë. Bahçevaqit kanë pasë. Ni Milazimi bile ka pasë, qitu i ka pasë arat. Ka qenë Lagja e Muhaxherëve edhe që i thojshim Çekliku, ku osht' parku sot ato kanë qenë varreza, varreza kanë qenë. Ka qenë ajo ndarje shumë e madhe.

Domethonë ku osht' sot Sllovenia Sportit aty kanë qenë qato shtëpia të fundit të Prishtinës, te Sllovenia Sporti. Qitu ka qenë te spitali i ri atëherë që i thojshim ka qenë Divanjollli. Ata në përgjithësi kanë qenë rom. Divanjoll osht' fjalë turke domethonë përafërsisht rrugë vertikale, divan osht' vertikal, rrugë e drejtë është divanjoll. Spitali i vjetër aty ku osht' Ministria e Shëndetësisë. Ku osht' që i thojmë

Dragodan, ka qenë vneshtë kjo pjesë deri te varrezat anena. Përmi urë, përmi hekurudhë s'ka pasë, unë e mbaj mend, asni shtëpi s'ka pasë pos keramika. S'ka pasë asni shtëpi hiç.

Ndoshta është për m'u cekë, te ura që shkohet për Podujevë, përmbi hekurudhë kanë qenë varrezat e dyta. Me 1959, se shumica nuk e dijnë, ku osht' Shkolla Arsim Vokshi, bash osht' mbi varreza. Me 1959 janë mbulue me qëllim t'caktun ato varreza edhe ni prej udhëheqësve kom qenë unë. Personalisht unë kom qenë se isha në gjimnaz atëherë 1959-ten. Ishim shkollat e mesme. Mu më zgjodhen, unë merresha me sport edhe më zgjodhen si nifar' me qijtë ashtu komandanti për mbulimin e qatyne varrezave 1959-tin, ku është tash Shkolla Arsim Vokshi, të gjitha qato shtëpia.

Domethonë Parku i Qytetit të Prishtinës ka Lagja e Muhaxherëve kanë qenë varreza, u mbuluan me qëllim të caktun. Varrezat tjera që kanë qenë masovike ku osht' Shkolla Arsim Vokshi kanë qenë varreza, 1959-shin, jo moti, isha 19 vjeçar janë mbulue. Kto krejt me qëllime të caktune, me qëllime të caktune. I patën qit' edhe knena kah, do varreza i qitën në këtë lagjen e Matiçanit atje edhe ato t'parat edhe ato i mbuluen. Masanej... diçka që rrallë kush e përmend te Taukbaçka ku ka qenë që i thoshin Strilishtja, që i kanë pushkatue mbi 2000 anëtarë të mbrojtjes kombëtare, mbi 2000 anëtarë. E kanë mbulu me këtë tensionin e lartë, t'u shku në Taukbaçë.

I kanë qit' kto të tensionit të lartë me të gjitha ato. Aty janë vorros, ndoshta edhe për së gjalli, m'i 2000 atdhetar të mbrojtjes kombëtare që ka qenë mbrojtja kombëtare. Po kta ka shkru pak Sabri Novosella, ka shkru pak Jakup Krasniqi këtë rast. Po s'ka ndërmarrë kërkush. Domethonë edhe ajo. Masanej Varrezat e Jahudive pak ma nalt, se ka pasë Jahudi në Prishtinë. I di shumë mirë edhe me emra i kom ditë. Ato i patën, i patën zhduk. Mirëpo pas luftës dikush gjet ni, ni mirësi edhe sado kudo...

**Anita Susuri:** A ju kujtohet ktu që ka qenë afër te Qafa diku kjo, ni e Jahudive, si i thonë...

**Muharrem Musliu:** Sinagoga.

**Anita Susuri:** Sinagoga?

**Muharrem Musliu:** E tash po ju tregoj. Ktu ka qenë te Qafa ka qenë ni Sinagogë e vogël. Mirëpo 1956-ten dikush thotë '58-ten, ka qenë ni xhami ku osht' sot Hotel Iliria edhe ni kishë ku është Shtëpia e Mallrave e vjetra te busti i Zahir Pajazitit. Ato te dyjat i kanë prish. Ajo ka qenë ma tepër Sinagogë, ma tepër Sinagogë jo kishë katolike po Sinagogë ka qenë. Sepse shkonin aty... qitu ka qenë po kta e prishën meniherë. Kanë qenë katër-pesë teçe, nashta e dini çka janë teçet?

**Anita Susuri:** Po.

**Muharrem Musliu:** Të dervishëve. Ato i kanë shkatërrue, vetëm ni ka mbetë te gjimnazi e familjes Maksut Shehut, vetëm ajo ka mbetë. Se një ka qenë që thojshim na atje në Pozerkë te Mullini i



Bankoviçit, qashtu ka qenë. Ka qenë edhe ni te Kandilia te Emin Duraku, qashtu i thojshim Lagja Kandilia. I kanë prish me qëllime t'caktune. Domethonë sistematikisht çka ka qenë shqiptare kanë dashtë me shkatërrue. Mirëpo për gjenerata të reja nuk e di që po interesohen shumë, po m'vjen keq. Mirëpo osht' mirë me ditë kto gjana, osht' mirë me ditë çka ka ndodhë viteve '50-ta, '60-ta, '70-ta, '80-ta edhe '90-ta edhe viteve '90-ta.

Deri në '58-ten na qitu në Prishtinë deri në moshën 18 vjet s'kemi guxu me dalë n'qytet. Deri në '58-ten. '57-ten, '58-ten u mbyllen të gjitha shkollat e mesme jo vetëm në Prishtinë po krejt Kosovën. Thojshin nuk ka nxansa. I vetmi Gjimnaz i Prishtinës Ivo Lola Ribar tani Sami Frashëri, mbet si lice, si lice domethonë. Diçka ma e lartë. Qaty që kom qenë unë, që kemi qenë disa vet që ka dhanë kuadra, një prej kuadrave ma t'mira. Ose ma vonë Normalja e Prishtinës që ka qenë fidanishte e arsimit, fidanishte e arsimit. Se kush s'e ka kry normalën është zor m'u bo arsimtar.

**Anita Susuri:** Po du edhe me ju pytë që e përmendet kta hebrenjtë, a ka pasë mas Luftës së Dytë ktu? A keni njoftë ju njerëz? Me çka janë marrë ata?

**Muharrem Musliu:** Mas Luftës së Dytë ka pasë shumë mirëpo në përgjithësi kanë qenë, kanë pasë dyqane. Ni familje ka pasë ni dyqan ktu, vizavi komunës tonë, n'atë anë anena ku përpara quhej si te magarxhit (qeshë) sepse rrishin ata me bajt diçka. Masanej kem ba aty thojshin lana e miellit sepse shitej mielli. Masanej u ba lana e grave (qeshë). Pa ofendime, qashtu thojshin. Se rrishin gratë e shitshin diçka, a din. E lam i thojnë dihet ajo fjalë shqipe osht', ku u shit, qaty kanë qenë.

Masanej kanë qenë kta Bërliqeviqët që kanë folë serbisht. Prejardhjen e kanë prej, nana e tyre ka qenë hebreje po u martu sigurisht me naj ortodoks. Masanej ka qenë edhe ni familje qitu dikund te Divanjollli, vizavi Shkollës Meto Bajraktari edhe ata kanë shku herët. Mirëpo atë kohë edhe neve diqysh, i merrshim si diçka që nuk janë tont. S'po di edhe si t'hujt, s'po di edhe si me spjegue, a din. A thojshim, jahudi, jahudi. Nuk e dishim na edhe çka janë jahudi, jahudi, jahudi. Se kanë qenë të përndjekun.

Thojnë që vitin '40, '41-'43 ka pasë shumë në Prishtinë që kanë ikë prej Serbie. Kanë kërkuë strehim ktu. Janë për shembull kta Rezniqët që kanë Sllovenia Sportin që kanë pasë. Ata janë me prejardhje hebreje. Bile atë Hazbije Rezniqin e kom pasë shoke t'klasës. Mirëpo vonë kemi marrë vesh se edhe nuk kanë tregu edhe s'kanë tregu. Nuk kanë tregu shumica e shokve që ua kanë pushkatu baballarët ktu në Prishtinë. Nuk kanë tregu n'shkollë knej anej që mos me pasë malltretime, që osht' me t'vërtetë e kuptueshme.

Ndoshta ni rast i intereson dikuj për rastin e Miladin Popoviçit. Unë edhe dy-tri herë e kom thanë edhe kom thanë ni televizion mirëpo nuk e kanë qit. Dy shok t'mi në gjimnaz Ismet Sadiku i Ferizajit edhe Ali Buqinca, banojshin te halla Shahë. Halla Shahë është e Gjingjive. Domethonë e kanë shtëpia e atyne Gjingjive osht' afër "Miladin Popoviq" osht' qytë deri sot kjo biblioteka ktu afër diku. Unë shkojsa te

ata shoktë aty edhe bisedojshim turqisht unë me hallën Shahë. Se djali i hallës Shahë, Agushi ka qenë me ni klasë me Shaipin, me vllaun tim. Bisedojshim.

Tash në bisedë e sipër unë kisha ni që ktu në qat' shpi osht' vra Haki Tafa. Po e pyti. Tash ajo po m'tregon kshtu, "Po osht' e vërtetë", se ktu në Prishtinë e kanë pasë shtëpinë katin e dytë e kanë pasë edhe katin e dytë i kanë thanë samallëk turqisht, i bjen pleme te na shqip. Samallëk pleme. Kanë lanë kashtë e çka ka pasë nevojë. Selveti, çika e hallës Shahë e nin që diçka po lëviz në tavan. Shkon e shiqron, kur e sheh ni njeri aty edhe don me bërtitë. Ai thotë, "Mos bërtit". Kjo meniherë del edhe bërtet, "Milica, milicia, milicia".

Qysh tregonte halla Shahë, po thom prej gojës së hallës Shahë, "Janë kanë", tha, "disa herë edhe shumë herë", thotë, "ai ka nxjerrë revolën edhe ka vra vetën. Kur kanë ardhë milicia e kanë gjetë t'vdekun". Po tash çka osht' interesant, Selveten s'e ka marrë kërkush në Prishtinë, këtë Selveten t'cilën e kom njoftë personalisht. S'e ka marrë kërkush. Është martu thojnë me nifar' Bude ni serb. Ai Buda ka qenë ni pianec i rrugve ktu të Prishtinës. Se ni kohë t'gjatë nuk osht' martu. S'e ka marrë kërkush se ka ditë që ka tradhëtue edhe s'e ka marrë kërkush.

Rastësisht unë para dy viteve u takova me ni nip të Agushit. Tash ai po m'tregon, sa osht' e vërtetë sa s'osht' e vërtetë, haptaz po m'tregon kshtu po thotë, "Djali i Selvetës që ka jetu në Beogrda me qat' Budën ka qenë shofer vitin 1999 që", shofer i Serbisë, "kur osht' bombardue ni autobus te ura e Lluzhanit", që kanë vdekë shumë në autobus, "ai kish qenë shofer ku edhe ai osht' vra". Çfarë rast shumë interesant. Ktu në Prishtinë, prishtinasit e vjetër krejt e dijnë që n'familje të xhinxhive që është ende ajo familje, qatje ka shtëpitë.

I thojshim ni hapësirë ka qenë yeni hajat, domethonë, yeni osht' turqisht e re, hajat me qujtë aty ni hapësirë që lujshin ballo. Ende osht' ajo pjesë aty. Qaty edhe llogaritet ni familje që e ka tradhëtou Haki Tahën. Miërpo kta të historisë nisen prej do dokumenteve që i kanë shkru vet serbët, ata kurrë nuk e thojnë të vërtetën. Domethonë dokument të vërtetë ata nuk lanë. Po e lanë ni dokument që nuk osht' e vërtetë dhe masanej ajo po bohet e vërtetë. Unë nuk e di për qat' kohë nuk osht' interesant për juve po neve në atë kohë i kemi urrejt kta që kanë qenë në politikë shqiptarët. Sepse i kemi llogarit që janë bashkëpunëtor.

**Anita Susuri:** Po m'intereson edhe diçka lidhur me këtë kohën e pas luftës, për atë pjesën Tre Sheshirat ku janë, ku osht' universiteti. Po m'doket që ka qenë ni ujëvar a çka ka qenë?

**Muharrem Musliu:** Ara kanë qenë aty masanej i kanë pasë do kazerma ushtria, i thojshim sajak. Sana ushtria i lejshin aty shumë m'i marrë. E shkolla përfundi që ka qenë ku osht' sot katedralja, ajo ka qenë niherë komunë, masanej ka qenë kazermë, ka qenë edhe si shtëpi e shëndetit. Të gjitha ato kanë qenë qaty. E vetmja qajo ka qenë qaty. Kto përmbi krejt ku osht' universiteti sot, ku osht' Fakulteti Filozofik e

kto ara kanë qenë. Mirëpo ushtria ka qenë i kanë pasë do kazerma, do baraka që kanë qenë deri vonë do baraka aty afër me televizion kanë qenë do baraka aty. Po ato kanë qenë jashtë Prishtinës.

Ku osht' Banka Qendrore, ku osht' Hotel Grandi ka qenë ni, me qujtë sallahane. Sallahane është ku i kanë pre kafshhtë përpara, që i kanë pre kafshhtë. Ku osht' Shkolla Arsim Vokshi, jo Arsim Vokshi m'falni, po kjo shkolla që the te Tre Sheshirat aty, Faik Konica. Aty ka qenë nifar' pazari ka qenë. Ka qenë nifar' pazari edhe aty. Ka qenë pazari masanej edhe kha nalt në Pozerkë përte Hanit të Dilit. Hani i Dilit shtëpia e Xhelal Sveçlës ku osht' ka qenë e fundit. Masanej ato anena u ba Stadioni i Flamurtarit.

Përtej Stadionit të Flamurtarit ka qenë ni bazent që ka pasë Prishtina. Ka qenë ni bazent ku osht' Shtëpia e Armatës ktu, ku osht' EULEX edhe ktu ka qenë ni bazent. Qaty ka qenë stadioni i parë i futbollit të Prishtinës, i rrethun me drrasa. Ku m'ka ra edhe mu me lujtë qaty derisa u bo ky, kjo fusha knena. Prishtina thuhet në 1936-ten i ka pasë 16 mijë banor. Po çka osht' interesant na deri në vitin '60 jemi njoftë krejt qyteti mes veti. Kemi njoftë krejt qytetin, çdo rrugë kemi ditë, jemi njoftë. Mirëpo tash sot s'pe njohim as (qeshë) as vetëvetën kanihere. Diçka tjetër për këtë kohë deri '60-ten nuk p'e di çka osht' me ju tregue...

**Anita Susuri:** E kjo për shembull që përmendet Xhamia e Llokaçit...

**Muharrem Musliu:** Xhamia e Llokaçit, ndëgjo, Xhamia e Llokaçit '56-ten u prish. Se ka qenë Ura e Llokaçit, ku osht' kjo Kafja Skënderbeu, tash që e kanë bo, që e kanë qit' aty ka qenë ni urë. Kta i kanë thanë, turqisht i thojshin *Qypri Llanasi* domethonë Ura e Lakrave se janë shitë lakna qaty shumë. Kta i thoshin *Kupusishte* serbisht. Ajo ka qenë ni urë, Ura e Llokaçit, Xhamia e Llokaçit ka qenë qaty. '56-ten u prish. Kur u prish edhe Sinagoga te busti i Zahir Pajazitit aty.

**Anita Susuri:** Qat' pjesën qanej po m'duket ka qenë edhe si kapali çarshia...

**Muharrem Musliu:** Kapali çarshia ose çarshia e mbyllur ku osht' parlamenti, ku osht' ka qenë posta e vjetër ma poshtë. Prej postës së vjetër deri te xhamia e çarshisë që kemi thanë sot, që osht' ende e pa meremetune te rrethi ka qenë, kanë qenë sikur kapali çarshi. Zanatlive krejt ku edhe vllavi im e ka pasë rrobaqepësinë. Shaipi, vllavi im e ka pasë. Aty me t'vërtetë me kazanxhi, me teneqexhi, me rrobaqepësa me krejt qaty ka qenë diçka e jashtëzakonshme. E prishën ata.

Domethonë ku osht'... edhe ka qenë sigurimi social ka qenë ku osht' ajo ndërtesa... domethonë krejt ai kompleks prej postës të vjetër deri aty. Rruga ka qenë kah osht' përmendorja, kryqi ka qenë. Një që shkon kah Xhamia e Llapit, tjetra kah qyteti, kah gjimnazi edhe qikjo rruga te poshtë. Mirëpo e prishën. Për përmendore ndoshta osht' interesant me ju tregue. Kur kanë fillu me ba qat' përmendore i vetmi që ka pasë reagu ka pasë qenë Ilaz Kurteshi, i vetmi n'atë kohë. Sepse ka thanë që nuk paraqet kjo vllaznim bashkim po osht' ni monument që paraqet mbretësinë serbo-kroato-slllovene me ata tri kshtu {shpjegon me duar trekandëshin}.

E kam thanë me ni tubim ku kanë qenë kta akademikët thashë, “Unë personalisht e kom thanë, botnisht ajo osht’ përmendore e turkit edhe ofendim edhe për slloven edhe për kroat”. Ajo nalt atje paraqet mbretërinë serbo-kroato-sllovene që ka qenë para Luftës së Dytë Botëtoe. Kta e bon si vllaznim bashkim. Bojshin hajgare serbët, se s’po thom shkijet po serbët. Thojshin, “Serbët, kroatët dhe sllovenët janë nalt e qe ju brithymtë shqiptarë poshtë jeni kha. *Slomljena rebra* [srb.: brithyer] thojshin jeni poshtë knena”. Haptaz na thoshin. Me të vërtetë qashtu osht’.

Mirëpo nuk e di. Janë bo gabime ktu. Janë bo ndoshta me qëllim e pa qëllim e se edhe kisha në kampus aty, ajo ‘99-ten ka mujtë gjithkush me prish ata edhe mos me dhanë kurfar’, a din përgjegjësie edhe përmendorja. Por kanë mbetë. Tash kanë mbetë gjithmonë qaty, nuk munësh sot. Pa marrë parasysh kush osht’ n’pushtet nuk munet. A kanë mujtë në ‘99-ten. Se unë gjatë luftës ‘99-ten me krejt familjen kom qenë në Prishtinë. Qitu kom qenë. S’e kom lshu Prishtinën hiç.

**Anita Susuri:** Flasm edhe për ata po tash po du, thatë, që shkollën e keni përfundu ktu në Ivo Lola Ribar që ka qenë. Po pastaj keni vazhdu edhe shkollën e jo...

**Muharrem Musliu:** Jo. Kom hy në punë menihere edhe kom mbetë. Se të gjithë e kisha gjendjen e familjes, njëmbëdhjetë anëtarë, baba u smu nuk mundte me punu. Ishim njëmbëdhjetë anëtarë të familjes edhe duhej me mbajtë familjen, çka osht’ kryesore. Edhe punojsha edhe lujsha futboll. Domethonë kur lujsha futboll diçka e ndihmojsha familjen edhe prej punës edhe prej futbollit. Hyna, ishim në Kosovë masanej shkova për Obiliqin në Ligë të Dytë Qendrore të ish Jugosllavisë. Kom lujtë deri në vitin ‘71.

E di 48 mijë dinar në atë kohë ‘65-ten i marrsha n’punë ktu a 60 mijë i merrsha prej futbollit. Domethonë njëmbëdhjetë anëtarë të familjes i vetmi unë isha në punë, duhej m’u kujdes për familje. Jeta ime ka qenë e tillë. Shpesh here shkojsha prej ktuhit në Obiliq pa drekë, kthehesha dhe s’kishim as drekë. Çka kishim me bajtë në vend të kpuve ju thojshim do jadrankave me dy gishta që u kapshin. Kur u kputke ajo duhej dathun me shku në shtëpi. Ashtu ka qenë jeta. S’kemi pasë as çka me veshë as...

Ashtu ni rast që e përmendum në shkollë. Kah 1952-shi, ‘53-shi patëm ble do miell. Ai kish qenë egjër, egjra ju t’ritë nuk e dini çka osht’. Nifar’ lloj droge. Ka qenë qashtu nifar’ lloj bari që osht’ rritë me grun edhe atë kur e bonte nana bukën për me hangër ata, praktikisht ishim n’gjum. M’kujtohet jashtëzakonisht mirë. Duhej me shku n’shkollë, sikur me dy sy mbyllë. Gja nuk shihsha. Shoktë më ndihmojshin. Nuk shifsha kurgjo. Krejt familja qashtu. Duhej me hangër qata për me jetu.

Kur shkojsha gati gjithë familja që ishin ma t’ri se unë rat i gjejsa. Egjra ka qenë e tillë por duhej me hangër. S’kishim prej qkafit me jetue. Ka qenë... për m’u kthye n’atë kohë duhet me pasë... shpesh

herë nuk guxoj edhe vetëveten me kthy mrapa sikur nuk guxoj me kthy vetën '99 ktu çka kemi përjetue. Mirëpo jeta ishte plot sfida, plot sfida e po deshke njeriu me i përjetue, m'i përballu të gjitha.

### Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** M'thatë që prej vitit '61 keni fillu edhe me punë edhe aktivitete sportive, po tash po m'intereson krejt qito vite si kanë qenë për juve? Për shembull për punën si ka shku? Për stërvitjet...

**Muharrem Musliu:** Për punë, për punë ktu në Prishtinë kom qenë një prej punëtorëve ma t'mirë me modestinë ma t'madhe. Sepse katër herë që kom marrë pjesë n'do gara federative që thojshin të Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror kom qenë, jom zgjedhë ma i miri. Kemi qenë 12-13 mijë i ka pasë Shërbimi i Kontabilitetit në Jugosllavi. Mirëpo kom qenë ma i miri sepse e kom dashtë punën shumë, e kom respektue, nuk jom vonue kurrë.

Kurrë s'i kom dhanë llogari kërkuj, kurrë s'ka ndodhë me pasë shefin shqiptarë, kurrë s'ka ndodhë me pasë drejtorin shqiptarë. Gjithmonë e kom pasë serb. Kurrë shefit n'jetë time s'i kom thanë a mundem me shku diku po po shkoj. E kanë ditë që kom qenë, veç kur kom pasë nevojë. Mirëpo për me shku në stërvitje... sepse lujsim nëpër Serbi, t'u fillu prej Vranjës, Leskocit, Nishit, Kragujevcit e Kralëvës, Çaçakut. Krejt kto u duhke me hsku, me udhëtue. Kta e dishin, kta në shërbim ktu e dishin. Mirëpo visha në punë, punojsha edhe kom nejt ndoshta edhe gjithë natën.

Masanej kom pasë qenë nifar' eksperti që thojnë edhe që kom qenë me shkollë t'mesme. Kom punue, m'kanë çue me ju ndihmue edhe në Mitrovicë në ShKSh edhe në Prizren, Gjakovë, e në Pejë, në Ferizaj, Gjilan e gjithkah. Kosovën e ngjoh si xhepin tim, s'ka katun gati në Kosovë që nuk e di. S'ka rrugë, rrugicë që s'e di. Sepse kom pasë shokë gjithkah edhe në Luginë të Preshevës. Sporti m'ka ndihmu shumë. Masanej isha n'qat' kshillin qaty për Pajtimin e Gjaqeve kemi qenë gjithkah.

Janë do gjana që jeta ime osht' interesant se mu n'konvenon veç shëtitja, po natyra mbi t'gjitha, natyra mbi t'gjitha. Qytetet nuk i pëlqej shumë, nuk i pëlqej. Natyrën e du shumë. Rregullisht jam në Gërmë, krejt e dijnë. Eci kah dhjetë 15 kilometra. Viteve '60-ta shkojshim nëpër Serbi me lujtë futboll, a besoni na u shajke nana shqiptare si n'pazar. Edhe që ishim veç unë e Hamdi Gogori edhe ni Ismet Maliqi, shumë shqiptarë të gjithë ishim serb. Po edhe serbëve ua shajshin nanën shqiptare.

M'kujtohet 1966 në Bar të Serbisë ishim 14 mijë vet gati. Njanën anë na shajshin, "*Majku vam shiptarsku*" keta tjeret ne kor "nanën shqiptare", shahej. Na kemi qenë, unë kom qenë i pa kompromis. Fizikisht kom qenë një prej lojtarëve ma t'pregatitun në Kosovë. Ka pasë shku '63-shin Gani Ajeti, po jo ma i miri, po fizikisht ma i pregatituni se ma t'mirë se unë ka pasë shumë edhe shumë. Viteve '50-ta, '60-ta ka qenë ni Avni Zhubi që është ende gjallë. Masanej viteve '70-ta, '80-ta dul legjenda jonë Fadil Vokri. Një prej lojtarëve ma t'mirë që ka pasë Kosova.

Tash viteve '90-ta kom qenë në kryesi të Federatës Kosovare të Futbollit, gati kryesori. Rexhep Avdullahun e kemi pasë kryetar po unë kom qenë mas aktivisti. Të gjitha ndeshjet për kupë n'atë kohë... m'kanë marrë policia nja pesë-gjashtë here. Me m'rraf nuk m'kanë rraf. M'thojshin, "Ku po punon?" Thojsha, "Në Shërbim të Kontabilitetit Shoqëror", sepse ka qenë ent shtetëror Shërbimi i Kontabilitetit. "Çka je ti?" "Inspektor", "Po çfarë inspektori bre kjo ligë e egër, *divlja liga*", a din. Thojsha, "Po profesionin e kom", se kom qenë edhe trajner i Besëlidhjes kom qenë. Nuk m'kanë rreh, kjo është e vërtetë. Nja gjashtë herë m'kanë marrë n'pytje edhe në stacion m'kanë çu po me m'rreh s'më kanë rreh.

**Anita Susuri:** Vitet e '90-ta?

**Muharrem Musliu:** Vitet e '90-ta.

**Anita Susuri:** Po m'intereson tash qysh ka fillu krejt ky aktivizmi politik? '68-ten demonstratat keni qenë pjesëmarrës, qysh ka fillu?

**Muharrem Musliu:** Kshtu, 1958-ten u burgos Adem Demaçi, unë isha në Gjimnaz të Prishtinës atëherë. Ademi ishte tri gjenerata. Se kur isha unë në tetë vjeçare në gjimnaz ai ishte në gjimnaz edhe kshtu. Zakonisht na çka jemi ma t'ri i njohim ata ma t'vjetër. Ai shkonte nëpër do orë letrare unë u mirrsha me sport, me futboll. Domethonë pa naj far' modestie Ademin e njifshim krejt mirëpo më njifshin mu edhe serb edhe shqiptar. Se lujsha futboll.

Kur ra Baca Adem n'burg me Nehat Islamin gazetar, me Gani Spahiun, me Ismet Sadikun, me Nysret Zijabegun doktorin. Kaniherë jo që bisedojshim kshtu haptas po qysh ra, pse ra, tek ra n'burg. U interesojschim. Unë kisha t'mit i kom pasë në NDSH edhe nëpër neja e nëpër oda te na ku kemi shku tjetër nuk është folë veç për çashtje kombëtare. Domethonë e kom marrë prej familjes, prej dajve, prej nipave. E kom ndi atë peshën tonë kombëtare mirëpo me shokë diqysh ma nuk kemi bisedue.

Me Hilmi Rakovicën kom qenë në ni klasë prej klasës t'parë fillore, tetë vjet. Masanej ai shkoj në normale unë mbeta në gjimnaz. Kemi qenë shokë ma t'ngushtë të jetës që ka dy shokë. Thojnë në Prishtinë, kanë thanë, nëse ka dy shokë t'ngushtë kemi qenë unë edhe i ndjeri, Hilmi Rakovica. Shoqnoheshim gjithmonë bashkë. Hilmiu 1963-ten hyn në partinë e Adem Demaçit. Unë shkova ushtar. Mirëpo kur erdha në '64-ten në pushim kta ishin konë burgos krejt. Edhe Hilmi Rakovica ish burgos si kryetar i të rinjëve.

Masanej '65-ten u ktheva unë, dul Hilmiu prje burgut. '67-ten... masanej kta të demonstratave '64-ten ia fillun me dalë prej '67-ten. I kom njoftë edhe përpara mirëpo me Ilmiun gjithmonë bashkë. I kom ngjofte për afërsisht të gjithë të Kosovës që kanë qenë nëpër burgje '68-ten. Përfarësisht 100 nëse kanë

qenë 90 i kom ngjoftë edhe kanë qenë në shtëpinë time. Tjetër biseda te na nuk osht' ba nëpër shoqni. Kurfar' bisede tjetër, vetëm për çashtje kombëtare, kurfar' bisede tjetër.

1968-ten unë i njëfsha, se vishin në dyqan të vllaut, rrobaqepës te televizioni i vjetër aty. Me Osman Dumosh, me Skender Muqoll, me Skender Kastrat, ky Hasan Dërmak, Afrim Loxha. U shoqnojshim e shkojshim me ta. Ismail Dumoshi ju kish pasë thanë vllaut t'vet Osmanit edhe Hasanit, thotë, "Pse s'po filloni edhe ju? Ka fillu në Beograd, në Kroaci, në Çeko-Slllovakia e". Ato lëvizjet studentore. Ismail Dumoshi ka qenë kumara i demonstratave të 1968-tes.

Tash nëse ju intereson me ditë përafërsisht, unë kom qenë dora e dytë, jo dora e parë. Dora e parë kanë qenë qita që janë burgosë, qita nantë edhe shumë tjerë. Dora e dytë... Ismail Dumoshi ka qenë kumar, dora e dytë kemi qenë Ali Boletini, nipi i Isë Boletinit, burri i Hyrije Hanës, Hyrije Hana, Metush Krasniqi, Sabri Novosella, Hilmi Rakovica, edhe unë tash po duhet me thanë, edhe unë. Rregullisht takoheshim përpara.

Dy ditë para se m'u mbajtë demonstratat, domethonë, me 27 tetor 1968 kemi qenë në shtëpi të Hilmi Rakovicës në Lagjen e Muhaxherëve ku ka qenë Hasan Dërmaku, ka qenë Osman Dumoshi, ka qenë Selatin, ky Skender Muqolli, Skender Kastrati, Afrim Loxha, unë kom qenë, ka qenë Shaipi vllau. Kanë qenë edhe dy rrobaqepësa Ramushi edhe Tefiku, që pat' me ra me kta. Po i majtën kah dy muj ditë edhe i lshun. Kemi qenë plot aty.

Domethonë dy ditë para se m'u ba demonstratat. Ishin caktu demonstratat me fillue në ora 04:00 te Fakulteti Filozofik. Unë punojsha në Shërbim të Kontabilitetit Shoqëror ku osht' Ipkoja tash që osht' në qendër aty. E disha që në 04:00 fillon. Mirëpo dhetë minuta në 04:00 unë e lshoj edhe kur kanë ardhë tuba knena te Tre Sheshirat, që e ceke pak më parë, Afrim Loxha e kish pasë flamurin kombëtar. Jo flamurin e Shqipërisë, se shumica po i krahasojnë. Ai osht' flamuri kombëtar, flamurin kombëtar. Ia kom marrë unë flamurin, flamurin Afrim Loxhës.

Ni milic ka qenë në anën e kundërt anena, ka qit tri herë me revole, ka qit përpjetë. Domethonë dha alarm. Masanej erdhëm deri n'qytet ktu. Na fillum me dalë me i pru do çisterna i thojshin me na lagë me ujë. Bash ku osht' qendra, ku osht' para teatrit aty, ku osht' busti i Skënderbeut aty ka qenë një dhe ka hypë Afrim Loxha, i ndjeri që e kanë vra '99-ten, ka hypë edhe ia ka marrë atë zorrën (qeshë) dhe ia ka kthy milicve ata. E kom kshtu si pasqyre Afrimi.

Masanej fillun malltretimet, rrafjet. Osht' vendosë m'u lexu ni letër para teatrit aty. Ka dashtë me lexue Osman Dumoshi, s'ka mujtë. E ka marrë Skender Kastrati e ka lexue. Masanej atë natë gjithë natën na kanë njëkë, na kanë përndjekë nëpër rrugë t'qytetit. T'nesrit shkova unë n'punë. A din, ashtu e dishin që kom marrë pjesë. Mirëpo shkaku i sportit, e shkaku që isha i qytetit, që kisha shokë shumë e që kishim ndoshta familje kanë pasë nifar' frike, haptas po e them kta.

Mirëpo ni koleg i imi i punës, Mehmet Dervishaj, shkon në sigurim poshtë atje. Thotë, “Muharrem Musliu”, thotë, “gjithë ditën e ka shikue orën, dhetë minuta në 04:00 e ka lshue punën”. Ma kanë thanë edhe n’mledhje para t’gjithëve ma kanë thanë aty (qeshë) në Shërbim të Kontabilitetit kur u ba me i gjykue demonstratat. Domethonë e kem prej shqip folësve. Kur u bon demonstratat, na u kthym ku osht’ shtëpia e Armatës tash, aty kryesore. U tubum aty.

Mirëpo çka ndodhi? Kanë gjujtë ushtria edhe milicia po kanë gjujtë përpjetë. Dikush ka gjujtë prej banesave edhe e kanë rrokë Skender Muqollin qitu {te krahërori}. M’duket jaknen ende e ka me shenjë ktu e ka (qeshë)...

**Anita Susuri:** E ka rujtë.

**Muharrem Musliu:** E ka rujtë. Ktu e kanë rrokë {te krahërori}. Kanë ardhë do për mu provokator shqiptar, ‘Jo e burgosën Fehmi Pushkollin’. Fehmi Pushkollu ishte profesor në normale, profesor i historisë dhe e pat’ qit’ flamurin kombëtar. Ai Fehmi Pushkollu n’bazë të analizave t’mija që janë t’vërteta ai ka qenë te televizioni i vjetër me Hysen Rakovicën e Muhamet Limanin e me kta. Kanë qenë qendra e pionerëve aty.

Mirëpo e burgosën. Tash nisën tjetër me shku me nxjerrë prej burgut. Aty vritet Murat Mehmeti, qaty t’u shku me nxjerrë ata. Kur e plagosën Skenderin ishte afër meje, armtë i mbajke në lokal Sabri Novosella. E ka pasë lokalin rrobaqepës ku osht’ busti Skënderbeut pak ma poshtë ka qenë ni bahçe kozara i thojshin aty. Unë dhe Afrim Loxha shkojmë. E kemi gjetë aty Hyrije Hanën, Ali Boletin e edhe Metush Krasniqin. Ata i përcillshin prej atyhit qysh po ndodhë, çka po ndodhë.

Kur kemi shku aty thashë qishtu qishtu. I morëm dy revole unë edhe Afrim Loxha, prej Sabri Novosellës. Baca Metush decidivisht na ka thanë edhe mu edhe Afrimit, “Mos gjuni në ushtri e në polici se ju vrasin. Po runu prej anash mos t’ju vrasin”. Ai ka qenë ni prej vizionarëve ma t’mdhaj që kom njoftë unë, Metush Krasniqi. “Runu mos t’ju vrasin”. Nuk gjujtëm edhe na, nuk gjujtëm. Nuk erdh koha me gjujtë po qaty i morëm revolet.

Tash kta u burgosën nantë vet. Unë i kisha shokë të gjithë. Po bisedoj çka me ba që me ba ni aksion drejt të mallkun. Thashë, t’ja gjuj Gjyqit të Qarkut ni bombë ni natë para se me dalë kta në gjykim. Në Hogosht e kom marrë ni bombë t’cilën e kom ende sot, e kom thanë kta edhe në simpoziumin për 50 vjetorin e demonstratave të ‘68-tes, në simpozium e kom thanë. Dashta me dorëzu në polici po ende e kom edhe sot qat’ bombë në shtëpi e kom. Pata vendosë që në mramje me gju bombë gjyqit.

Mirëpo Baca Metush decidivisht m’tha kshtu, “Jo”, tha, “se atëherë kanë m’u dënu dy fish ma tepër si terrorista”. Se unë pata përgadit krejt terrenin mrapa gjyqit se qasajde kalojsha ditë e natë, i dihsa rrugicat kah me hy edhe isha në moshë 28 vjet, lujsha në Ligë të Dytë Qendrore të ish Jugosllavië futboll, domethonë kisha kondicion. Ku me u strehu krejt i kisha llogaritë.



Baca Metush, qe shkrun edhe Liman Ahmeti, n'qat' libër osht' e lexova. Decidivisht thotë, “Mos gabo me gjue se dënohen dy fish ma tepër, llogariten si terrorista”, 1969-ten, m'ka thanë Baca Metush. Mbeta qashtu ende e ruj qat' bombë qaty në shtëpi e kom (qeshë). P'e thom haptas kshtu. Ka qenë qishtu.

**Anita Susuri:** Po m'intereson para se m'u bo demonstrata domethonë organizimi që ka ndodhë, aty janë shkru parulla...

**Muharrem Musliu:** Parulla, krejt krejt parullat kanë qenë kryesore ka qenë 'Kosova Republikë'. Parullat të gjitha i ka shkru Skender Muqolli. I ka pasë në shtëpi Selatin Novosella, të gjitha. Janë majtë ato. Selatin Novosella me ni pajton i ka pru deri te Fakulteti Filozofik. 'Duam kushtetutë', 'Ja me hatër ja me luftë', 'Kosova Republikë'. Qito gjana kanë qenë kryesore. Parulla kryesore ka qenë, 'Kushtetutë, o' me hatër o' me luftë' edhe 'Kosova Republikë'. Po në nivel të Jugosllavisë, në atë kohë. Kjo ka qenë qashtu n'atë kohë në nivel të Jugosllavisë.

Ndërsa neve, qajo gjenerata e NDSH-istave e '43-tes, e '44-tes, e '56-tes, e '57-tes, e '68-tes, e '64-tes krejt kanë qenë për bashkim. Mirëpo bashkimin e kemi pa si trambolinë. Trambolinë e dini çka osht'? Kur kcen kërcyesi n'deti. Trambolinë për me u bashkue. Sikur sot që e kem shtetin tonë, Kosovën, osht' lloj tramboline për bashkim, a po kupton? Unë krejt jetën time ia kom kushtue bashkimit dhe ende jam për bashkim, ende jam për bashkim.

Nashta po dal prej ni teme ni temë tjetër se nëpër gara sportive gjithmonë krejt shiqesit po thojnë 'Shqipni etnike'. Tash po e thom para jush, që s'e kom thanë para kërkuj ni t'vërtetë se s'ka pasë rast. E vetmja, i vetmi institucion i Shqipërisë Etnike osht' Kombëtarja e Futbollit e Shqipërisë. Meqë ka lojtar të Shqipërisë bregdetare, që osht' Shqipëria e sotshme. Ka të Shqipërisë kontinentale që domethonë osht' Kosova, Maqedonia edhe Lugina e Preshevës.

E vetmja Shqipëri Etnike shihet në Kombëtaren e Futbollit të Shqipërisë, i vetmi institucion. Tjerat edhe këngëtarët edhe të gjithë këndojnë për Shqipëri Etnike e krejt, a Shqipëri praktikisht Etnike osht' qikjo kombëtarja. S'e di a pajtoheni a nuk pajtoheni po kjo është e vërtetë.

**Anita Susuri:** E vërtetë osht'. Po m'intereson edhe kshtu a ka pasë ndonjë thirrje, për shembull, ose si ka qenë vitet e '80-ta trakte që kanë shpërnda, diçka të tilla a ka pasë atëherë?

**Muharrem Musliu:** Ka pasë, ka pasë po jo shumë. Se qashtu kem marrë vendimin që mos me folë shumë për qata që i kishim n'pushtet. N'atë kohë Veli Devën apo Fadil Hoxhën apo këtë Ali Shukrin që e kemi ditë që Ali Shukria osht' njeri ma anti shqiptar se Ali Shukriu n'atë kohë s'ka pasë. Katër tradhëtarë ma t'mdhaj të kombit janë varros në Beograd, Esat Pashë Toptani, Aliu Shukriu, Mehmet Hoxha edhe Rrahmon Morina.

Mehmet Hoxha tash për me ditë se ju nuk i dini, Mehmet Hoxha osht' daja i Hyrije Hanës. Vllaun e Hyrije Hanës me 1948 e kanë vra si pasojë e Gjakoviçi. Mehmet Hoxha nipin e vet, ku osht' Televizioni i Prishtinës, i vjetri u shpallë hero në Shqipëri Xheladin Hana. E tash kur vdiq Gjije Hana, nana e Hyrije Hanës, erdh me vorros nipin e vet Hyrije Hana nuk e pranojti dajën e vet. Ke edhe ni, n'qat' varreza atje naltë e kishin pru kta Lidhja e Luftëtarëve Nacional Çlirimtare të Kosovës, e kishin pru ni kunor Hyrije Hana s'ja u pranoj ia gjujti. Ka qenë e pa thyeshme Hyrije Hana.

Kom qenë për to kom folë katër-pesë herë në Radio Kosova te nifar' Radije Hoxha. Ajo e ka portat e natës. Katër-pesë orë kom folë se kërkush s'e ka njoftë ma mirë se unë. Ajo ma shumë se i ka besue Metush Krasniqit edhe mue kërkujt s'i ka besu ma tepër. Mirëpo po harrohen kto gjana. Mu m'thojnë shpesh ti po i man mend t'gjithë, unë i maj mend edhe në klasë të parë fillore kond e kom pasë mirëpo vet jom pak dembel nuk kom shkru. Çka kanë shkru shoktë, çka ju kom thanë.

Ju tregova kanë thanë disa herë... erdh ni ditë njëni isha me shokë t'u nejtë, "Për NDSH-në a po na tregon diçka", thashë, "Jo se po shkruni, nuk po shkruni ashtu". Sot nëse don Muharrem Musliu me shkru ni libër për veti duhet me pagu ni profesor a dikë nja pesë mijë euro me ia dhanë edhe tash unë me folë gjana që s'janë t'mijat hiç, të pabesueshme. Jo e kom rreh filanin, jo kom qenë ktu, jo kom shpëtue kta, jo ky, jo ky. Domethonë ka shumë të pa vërteta. Unë qito që po i thom të gjitha, të gjitha janë t'vërteta çka i kom pa, i kom përjetue dhe i kom analizue.

**Anita Susuri:** Po m'intereson tash, thatë '69-ten që ndodhi kjo me bombën. Po qysh ka vazhdu pastaj? A jeni interesu prap për ndonjë akvitetet a si e keni përcjellë pastaj gjendjen?

**Muharrem Musliu:** Po, '71-shin me 09 janar '71-shin vdiq Hilmi Rakovica, shoku ma i ngushtë i imi. Edhe Zeqir Gërvalla, poeti, është në Amerikë shkrujti diçka dhe unë e kam lexue te varrezat atje. E kam lexue që n'atë kohë me lexu për t'burgosur politik ka qenë shumë zor. Binte ni borë e madhe. Kom lexu edhe t'u qajhtë. I kom dorëzue krejt çka kom pasë për Hilmi Rakovicën ia kom dorëzu Shkollës Hilmi Rakovica e cila osht' sot ni shkollë që quhet me emrin e Hilmi Rakovicës.

Ni drejtor e ka pasë jashtëzakonisht t'mirë, ni Ajet Brajshori. Ma shumë ai e njipte jetën e Hilmi Rakovicës mes nesh se na vet. Rregullisht më thrrasin për përvjetor, çdo përvjetor m'thrrasin atje. Bisedat tona kanë qenë rregullisht për çashtje kombëtare çka do t'bajmë, si do t'bajmë. 1972-shin '73-shin ia fillun kta që ishin nëpër burgje me dalë prej burgjeve. Rregullisht takoheshim, bisedonim.

1974-ten lirohet Adem Demaçi edhe Xhafer Mahmutxhiku. Ka qenë bashkë në burg me Adem Demaçin '64-ten. Zeqir Gërvalla edhe ai ka qenë. Ka qenë edhe Osman Dumoshi edhe unë në ish Hotelin Bozhur, tani është Iliria. Po bisedojmë se duhet me shku dikush me marrë prej burgut dajën, ish atje te afër Borit, te Zajçari ish atje. Thojshim mos kah e bijnë knena se dikush duhet me shku me marrë, mos po ia bojnë ndonjë atentat po ia qesin naj kerr e po e mysin.

Ra biseda që Shaipi, vllau im ishte rrobaqepës, e kishte ni fiq, e njihte Serbinë jashtëzakonisht mirë. Sepse shkonte me shitë rroba, me shitë nëpër të gjitha tregjet e Serbisë. Vendosëm që me shku me marrë. Mirëpo na e dishim që ka shku Ahmet Haxhiu, gjyshi i Albulena Haxhiut, të cilin e kishim shok. Ai e kishte si dajë, nip e dajë. Mirëpo si vozitës nuk ka qenë vozitës bash i mirë se i ka pasë mytë dy-tre vet (qeshë). Osht' histori ia dijnë krejt se osht' histori jeta e tij.

E dishim që Ahmet Haxhiu pa ju lajmëru Hyrije Hanës është e pamundur, osht' e pamundur. Unë shkoj, kta i la në hotel aty, shkoj unë te Hyrije Hana po rri me Hyrijen si zakonisht, kurgjo s'po i tregoj. Se nuk dojshim me bo t'madhe. Tash p'e thurret Ahmeti prej Nishit po thotë, "Motër na jem në Nish". Hyrja po çohet në telefon në Lagjen Pejton që thojnë, po çohet në telefon po thotë, "Mirë faleminderit që m'lajmërove. Nisuni knena me ardhë kah Bujanoci, kah Gjilani", thashë, "Jo, jo, jo Hyrije", thashë, "le t'vijne kah Nishi Prokupla se ata e dijnë". Tash Hyrija meniherë pa mendu hiç tha, "Jo vlla", tha, "nisuni knena".

Si ka thanë mas dy minuta tre... se masanej m'thojke, "Ti je tradhëtar", Hyrija, se s'i kom tregue (qeshë). Jom ardhë t'u nga në Hotelin ish Bozhuri edhe i kom thanë Shaipit, "Nisu me Zeqir Gërvallën", të dy janë gjallë sot. Nisën prej ktuhit përte Prokuples Shaipi e sheh Ahmet Haxhin t'u ardhë. Ju del me veturë përpara i nalë, e del e kap Adem Demaçin prej kerrit e nxjerrë e shtin në kerr t'vetin në tesha t'burgut. Drejt e bijnë ktu te motra e vet, te Parku i Qytetit nalt, te motra Ajshe. E bijnë Ademin. Ahmet Haxhia t'u ardhë me kerr t'vetin knena.

Po duket e kishin pasë përcjellë se kur kanë shku te shpija, ku e ka te lagja, qaty që i thonë te Mullini i Bankoviçit osht' atje, kur del Ahmeti del vetëm prej veturës po hin n'shpi, kërkush s'po del. Ata janë habitë. Diçka osht' e pamundur çfarë organizimi kemi ba. '74-'75 në përgjithësi kom qenë me Ademin, me Ahmet Haxhinë kemi shku te Metushi e krejt. 1975-ten kur u burgosë Adem Demaçi nuk ka pasë kurfar' grupe, hiç kurfar' grupe s'ka pasë.

Mirëpo çka ka ndodhë ktu? E shkrujti ni kërkesë në Higjiena Teknikë si përkthyes ia kom çu unë Ademit. E shkrujti edhe ni kërkesë në Bankos, ish Bankos edhe n'fund aty e shkruante, 'Vdekje fashizmit, liri popullit', unë e kom çu atë kërkesë për punë. Tash në Bankos ka qenë Latif Bunjaku drejtor, të cilin e kom ngjofte shumë mirë se kemi pasë kontakt bankat mes veti. Mirëpo kemi qenë edhe në gjimnaz. E merr letrën edhe e çon në komitet. Thotë, "Adem Demaçi ka konkurue. Kushtet i plotëson. A me pranu a mos me pranu?"

Në atë kohë, Mahmut Bakalli shpresonte se do t'bëhet Ministër i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë. E tash, për me likuidu Adem Demaçin edhe m'u tregu lojal ndaj Beogradit, p'e thom haptas se osht' e vërtetë. I gjejnë nja dy vet e formojnë ni grup prej 19 vetëve Adem Demaçit edhe i burgosin prej gjashtë vjete deri në 15 vjet. Dy vet ishin. Njëni prej tyre është Hetem Bajrami, i Gjilanit. Gjallë osht'. Ni për me

likuidu Adem Demaçin, dy m'i dënu edhe qita '68-tes se i dënun kah pak dhe ju mbetë marak m'i dënu edhe më tepër.

Osman Dumoshi, Hasan Dërmaku, Xheladin Rekaliun, Skender Kastratin, Ilaz Pirevën i morën. Qita i ka njoftë Baca Adem se ka qenë n'burg me ta. Mirëpo qita tjetër nja 14 vet të rrethit të Gjilanit anena që thojnë kah Shipashnica asnjë s'i ka njoftë, hiç, hiç asnjë s'i ka njoftë. Hiç asnjë s'i ka njoftë. Mirëpo ata kishin pasë ni organizatë e dikush e ka gjetë ni letër edhe ti burgosim edhe qita. I dënojnë prej gjashtë vjete deri në 15 vjet.

Në mënyrë ma të sinqertë e kanë thanë sigurisht edhe Selatin Novosella, e ka thanë nashta edhe Ilaz Pireva që osht' një prej ma t'fortëve. Nuk kanë pasë kurfar' organizate. Biseda kemi pasë. Kah kemi shku na... mu kur m'burgosën tha, "Po ju ku keni shku", tha, "keni folë kundër nesh, ku ka shkel kama juj", që ish e vërtetë. Mirëpo organizatë s'ka pasë. Kjo ka qenë me largu nga Kosova Adem Demaçin edhe m'u tregu lojal qita që na kanë udhëheq ndaj Beogradit. Kjo ka qenë qëllimi kryesor.

## Pjesa e Katërt

**Anita Susuri:** Folëm për '75-ten edhe kto kurdisjen me thanë që osht' bo për me u dënu Adem Demaçi, t'u e pa krejt kta domethonë orkestrimin, qysh ka qenë përjetimi juj për shembull që po ndodhin ksi padrejtësi? Çka ka qenë mendimi juj?

**Muharrem Musliu:** Po mendimi im s'kishte çka me qenë se e disha që ia fillum gjithmonë veç me burgosë, sa ma tepër t'ri, sa ma tepër t'ri. Meqë qaty ku mendojshin se ka ni lëvizje ose po shoqërohet me dikë ata i burgosshin sa vet e kanë pranue, gati kanë qenë 250 mijë dosje. Vet Rrahmon Morina e ka pranue. 200 domethonë, 750 mijë. Domethonë çdo i dyti shqiptarë ka pasë dosje. Kta e kanë ditë të gjithë. Masanej u burgosën në '75-ten u dënun kta, na prap s'kemi nejt. Prap s'kemi nejt.

Sepse Adem Demaçi edhe Metush Krasniqi... Metush Krasniqi e ka pasë që '74-ten në ni bisedë ku kanë qenë veç ata dy edhe unë kom qenë i vetmi që kemi qenë pesë-gjashtë orë, vetëm na tre kemi qenë. Ni bisedë pesë-gjashtë orë që e kanë ba. Metush Krasniqi e ka majtë gjithmonë ata, se ai ka qenë NDSH-ist i përбетum. Thotë, "Pa u forcu Shqipëria, pa na ndihmu Amerika nuk mundemi kurrë m'u shliurë", që doli krejt e vërtetë. Kurse Baca Adem pak mendonte pak ma ndryshe. Ai edhe ma ndryshe ka mendu deri vonë. Baca Metush ka qenë decidivisht, "Pa luftë nuk ka fitore".

Atëherë Baca Metush me Sabri Novosellën, Shefqet Jashar Strofcin që janë gjallë të dy edhe Ahmet Krasniqin, gjeneralin që u vra në Shqipëri, Ahmet Krasniqi. Edhe ai ka qenë në organizatë tonë. U formu ni organizatë edhe e bom grupin e treshes. Në qat'... '76, '77, '78, '79. Në qat' grup isha edhe unë në grupin e Sabri Novosellës, grupin e treshit (qeshë). Mirëpo Shefqet Jashari u burgos në '79-ten. Shefqet Jashari me të tjerë. Sabri Novosella iku.

Tash t'kish ra n'burg Sabri Novosella ndoshta edhe unë kisha ra. Nashta edhe unë i kisha qit' edhe dy t'mit, po thom ndoshta, kta me ndoshta. Mirëpo Sabri Novosella iku në Shqipëri e prej Shqipërie dul në Turki. Unë meta. Sot tregon Shefqet Jashari, ni Asllan Sllamniku ma së shumti e ka rraf shkaku i Muharrem Musliut. Shefqeti ka thanë, “Nuk e njoh”. Metushi e ata e kanë ditë që jom n'grup me ta. Mirëpo ky s'ka pranë që m'njef, kurrsesi. Tha, “Mundimin ma t'madh ni Asllan Sllamniku”. Sigurisht gjallë është ende. Mundimin ma t'madh ia ka bo shkaku im.

I kish pasë thanë ni shoku, “Qiky Muharrem Musliu veç mos më hift në dorë se llo me ba”. Që unë s'i jepsha pesë pare, isha i shnosh atëherë. Ra Baca Metush nuk ra e shpëtoj Shefqet Jashari, s'e ka dhanë. 1983-shin edhe mu më burgosën. Ma së shumti m'kanë mundu për Bacën Metush po s'e kom dhanë. Deri në '85-shen kur bjen me ni prej shokve t'mi ma t'ngushtë me Ramadan Haizirin e Ferizajit, ni prej shokve ma t'ngushtë të jetës time.

Në burg praktikisht dy javë masi dul prej burgut vdiq, prej rrahjeve. Jo rrahjeve po rrahje shtazarake. Njeri gjallë osht' sot ktu. E kom thanë në televizion. Osht' Zymer Zymeri osht' i Mulliqit. Dy metra burrë osht' paralizu del me ni krryle, e me ni sy që u paralizu. Unë pesë muj e kom pasë hetues. Ishim ni tubim qitash pak ma herët për Metush Krasniqin ke edhe Profesori Haki Bajrami tha, “Nuk bon”, tha, “me emra me mbiemra se kanë fmi”, u çova thashë, “Jo, ai osht' dashtë me mendu për fmi t'vet se edhe unë kom pasë fmi”, thashë, “edhe Baca Metush ka pasë pesë fmi. Ai le t'mendon për fmi t'vet, pse unë me mendu”. Me emër me mbiemer e thom në televizion haptas.

Ma së pari e kom thanë në Televizion të TV Mitrovica, kom thanë që Zymer Zymeri e ka mytë Metush Krasniqin. Kjo osht', s'e di kah 2005, a 2006, nuk e di. Me Fehmi Elmazin kom qenë, qit' Fehmi Bajramin që the s'po muj e gjej, dhe me Sabri Novosellën. Unë e thashë, haptas e thashë, në televizion e kom thanë. Kjo osht' e vërtetë. Tha, “Hypte në karrige, mu m'shtrente poshtë me te dy kamtë”, se osht' i madh, “më kcente në gjoks”. Dy herë ka pasë infarkt në burg sa ka qenë. '85-ten.

Po shumë interesant. '83-ten e kom pasë Zoran Dragoviçin hetues, Zymer Zymerin edhe Lufti Ajazin. General Luta, i Drenicës që thoshin. Ka vdekë. Qe s'disa herë po ia hjekin... ka dekë në Kurshumli atje ka ikë. E kanë vorros në Stankovc qitu të Drenicës po po ia shplojnë vorrin e po ia hjekin trupin. Se General Lufta e thirrshin edhe shkijet General Luta. Ka qenë i pa shpirt ka qenë. A Zoran Dragoviçin unë e kom pasë lojtar, se trajner kom qenë ni kohë t'gjatë. Tash po kaloj te vetëvetja. Kur u burgosëm në '83-ten...

**Anita Susuri:** Si ka ndodhë fillimisht burgosja?

**Muharrem Musliu:** Interesant ka qenë burgosja ime dhe janë habit krejt Kosova (qeshë). Ni tezak i imi ka qenë milic, ka punu milic. Shkon në kufi të Shqipërisë aty, ku osht' Vërmica ka qenë punkti i milicisë së tyre. Shkon ka punu si depoist aty. Kinse me shku me inspektue diçka edhe rrijnë sa rrijnë edhe ni

tjetër e dalin tash milicia dalin n'kufi aty. Ky ni çantë aso me veti edhe nja dy revole. Ia bon ktyne, "Ditën e mirë se shkova për Shqipëri", në pikë të ditës. Kta thojnë, "Ali ku po shkon?" Ali Buzaku osht' n'pytje. "Ali ku po shkon? Ali", ky thotë, "Shkova për Shqipëri".

Tash ai ushtaraku në Shqipëri i thotë, "Ali ndalu", thotë, "se po hyn në Shqipërinë e shtetit shqiptar", ky thotë, "Jo", thotë, "po vi me vdekë te ju". Ata tri herë i thojnë, ky hin anena, kta t'u kqyrë. Masanej e shpjegoj. Del në Shqipëri. Rrin ni kohë atje. Tanë u habitëm na, dul Ali Buzaku, milic dul iku në Shqipëri. Mas nja '82-shin, '83-shin del në televizion dy-tri here. Se e kthyn ata knena. Po e kanë ba ekstradimin, Ismail Dumoshi m'ka tregu, e kanë bo ekstradimin. Kta e kanë dhanë dy vet, bashkëpunëtor të Shqipërisë çka i kanë zanë kta knena, kta e kanë marrë Ali Buzakun.

Del në televizion. Ni Sali Sahiti ka punu në Televizion të Prishtinës e kom pasë shok klase. Thotë, "E shisha e kom pa dy-tri herë në televizionin tonë", thotë, "Mu shoktë m'kanë qit' anena". Po mendoj vet me veti thashl o' ç'paska me hangër dikush (qeshë). Paskan me hangër dikush. E qitshin dy-tri herë n'televizion se deri sot në televizion veç dy vet kanë dalë që kanë qenë t'burgosur, Ali Buzaku edhe ni...

**Anita Susuri:** Në RTP a?

**Muharrem Musliu:** Në RTP ka qenë, në televizionin jugosllav, televizionin serb. Dy vet deri sot kanë dalë n'televizion njënin e dini s'po du me ua cekë edhe Ali Buzaku. Shkova te tezja krejt normal a din. Me 27, 27 korrik isha rat' në Ulpianë në banesë aty. Fjetën kom qenë kah 05:00 ora veç ma ka nxjerrë, ma ka çu çarçarfin ky Zoran Dragoviçi. E kom pasë lojtar ata, kom qenë trajner i tij. Tha, "*Lišen si slobode*, je i privuar nga liria", serbisht. Pashë kishin hi 20-30 vet aty mrena.

P'e shoh krejt ndërtesa Es 12 osht' vizavi konviktet, si t'i kalojsh semaforat që shkon për spital në të djathtë janë tri ndërtesa, i kishin rrethue. Ia nisën po kontrollojnë. Mu m'lidhën. Gja n'dyje hiç s'disha. M'lidhën. Kontrollo, kontrollo. Tha, "A ki diçka prej armëve?" Thashë, "Jo". Me t'vërtetë ia kishin gjetë vllaut tim, i vogli ish i martun i kish pasë dy revole aty. Njëni ka thënë, "Vishu edhe ti". Kur e pashë që kanë ardhë për mue, pse me ma marrë edhe vllaun. Thashë, "T'mijat janë ato", dy revole.

Dashtën me m'çu n'zyre ku osht' Banka Qendrore, isha katin e tretë e kisha zyrën e posaçme, isha nifar' lloj shefi i vogël aty. Po m'kontrollojnë. M'ka kontrollu Xhavit Kuqi kryesor, Xhavit Kuqi. Ka punue në Sigurim Shtetror, gjallë osht'. M'i gjet do libra që i kisha ble prej Rilindjes. Libra historike. Thashë, "Po kto të Rilindjes, botim i Rilindjes". Se diçka çka kom pasë që s'ka qenë, ka qenë interesant veç për mu jo për shtetin e kom lanë n'folldera në folldera zyrtar çka janë aty. Që shkrun për shembull R1, çashtje e shërbimit të kontabilitetit, aty kisha dokumentat e mija. S'isha qaq i marrë.

Mirëpo t'u shku përpjetë me kta tre përcjellësit po ju thom edhe dy inspektorëve, "Hajdeni me mue", u habitën. Ish Sadri Demë Shijaku edhe ni Muharrem i Pejës tash s'po m'kujtohet. Thashë që mos po

m'qesin diçka e m'thojnë qita e gjetëm, le t'i kom edhe dy dëshmitar. M'lidhën aty. Thashë... shefit ia çova serb e kisha. Thashë, "Qe çelësi i zyrës". Kta tash po i thojnë, qiky Zorani po i thotë, "Ka me qenë ka ni kohë te na". Serbt kishin bo banket aty (qeshë). Osht' e vërtetë, m'kanë tregu shokët.

Më morën më çun të nesrit meniherë në hetime. "Kënd e njef?" Thashë, "Po pyt, unë jom sportist pytmi për çdo njënin kah e njeh se qysh e njeh". Se unë kisha mbulesë. Tha, "A e ngjeh Metush Krasniqin?" Thashë, "Po", "Kah e njeh?" Thashë, "Mes Hilmi Rakovicës". "A e njeh Adem Demaçin?" "Po", "Kah e njeh?" "Mes gjimnazit". "A e ngje Xhafer Mahmutxhikun?" "Mes Hilmi Rakovicës". Krejt thojsha mes Hilmiut se Hilmiu kish vdekë, shoku ma i ngushtë. "E dijmë", tha, "na kush ka qenë Hilmi Rakovica".

Nja pesë muj ditë në hetime qaty. E tash qiky Zymer Zymeri që gjallë osht' tha, "Ty osht' dashtë me të burgosë në '68-ten, '75-ten dhe '79-ten", thashë, "Pse s'më keni burgosë?" Tha, "S'na kanë lanë m'u përzi në sport". Se sportistat kanë pasë privilegje, kjo osht' e vërtetë. '68-shen lujsa në Ligë të Dytë Qendrore të ish Jugosllavisë. '75-shen isha trajner i Besëlidhjes së Prishtinës, '79-ten i udhëheqssha djemtë edhe vajzat hendboll në Ligë të Dytë Qendrore të Jugosllavisë së Prishtinës. Domethonë isha nifar' aktivisti sportiv.

Tha, "S'na kanë lanë m'u përzi n'sport", që osht' e vërtetë. Se prej krejt sportistave që përmenda pak ma herët NDSH 1957-ten Islam Mumxhiun e kanë pasë burgos, i Prishtinës ka qenë. Ai ka qenë një prej lojtarëve ma t'mirë që ka pasë Kosova. Domethonë si futbollist, Islam Mumxhiu edhe '83-ten Muharrem Musliu. Mirëpo tha, "'75-ten, '68-ten, '75-ten, '79-ten", thashë, "Po". Se ka qenë interesant '68-ta erdhën kta të komitetit Shërbimi i Kontabilitetit m'i gjykue demonstratat mas dy-tri dite. Erdh edhe qendra jonë, ish poshtë, kto lpkò që janë aty.

Tash po propozojnë tre vet, m'i gjykue tre shqiptarë. Po propozojnë Muharrem Musliun serbët, ni Banush Gashin edhe Selman Istrefaj. Aty dy po pranojnë unë jo. Unë u çova thashë, "Po e di", thashë, "për çfarë arsye m'keni propozu mue, e di, i di qëllimet e juja", thashë, "mirëpo", kalova prej ni teme n'temë tjetër, "Fadil Hoxha ka thanë, 'Kush osht' kundër Skënderbeut edhe kush osht' kundër flamurit kombëtar osht' edhe kundër Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë'", thashë, "ju jeni qaq t'paftyrë as ftyrë s'keni", serbisht, edhe e kom lshu mbledhjen kom dalë jashtë.

E kanë propozu ni Rasim Shollën n'vend timin e s'kanë guxu me m'thanë aty. Masanej disa shokë t'mi jo u dashtë me qëndru. Thashë, "Mirë pse s'qëndrut ju? A e thatë naj fjalë?" Asni fjalë s'e kanë thanë. Unë s'pranova. Banushi ka pranu. Banushi i shkurtë ekonomist. Edhe Selman Istrefaj përkthyes. Ata kanë pranu unë s'kom pranu. S'kisha pranu jo... e qishtu ka qenë. Tash po m'çojnë te gjykatësi hetues në Prizren. Se landën Ali Buzaku e kish në Prizren ajte. Ju tregova ai Fadil Nushi më mori n'pytje s'kisha çka me pranu se s'kish kurgjo t'vërtetë.

Ali Buzaku kish thanë që Muharrem Musliu mu m'ka bind m'ka nxit me ikë për Shqipëri, m'ka bindë edhe m'ka nxit. Për sa? Për dhetë minuta. Që s'ish e vërtetë edhe sot e pranoj që s'o e vërtetë se e kom ditë kush osht' Ali Buzaku. E kom ditë që osht' i dobët, e kom ditë që osht' i dobët. Kurrë n'jetë time nuk kisha bo diçka. Se sot muj me thanë që osht' e vërtetë. Atje kur e qesin në Shqipëri, kumeditë mes tjerash se osht' shumë interesant në Bankë Qendrore punojsha ktu edhe shkova zyrtarisht mas lufte në Shqipëri atje. Aty punonte djali Kkelmendi, djali i profesorit tim Zekerija Rexhës. Zekerija Rexha ka qenë edhe në MUP<sup>2</sup>.

Kelmendi edhe u njoftova me të. Ai po më njofton me një që kish punu në sigurim shtetror të Shqipërisë që e kish njoftë Ali Buzakun. Koleg, punojke në Bankë Qendrore. Tash përfaqësisht po m'tregon. Mes tjerash e kanë qit' në helikopter e kanë shëtite që po t'kthejnë për Jugosllavi, Ali Buzakun. E çojnë në ni zyre ku fotografia e Titos aty edhe ai që osht' dashtë me bisedu me të serbisht po i thotë, "Ali nuk e ke kry detyrën qysh u dashtë me krye", ky ia nisë, "Po m'kanë malltretue, m'kanë rreh, m'kanë mundue". E shan, thotë, "Ende gjindesh në Shqipëri, ende gjindesh në trollin shqiptar".

E kthejnë knena edhe unë kom psu shumë. Kom psu shumë. Masanej dojsa kah mos... dy muj ditë unë s'kom ditë arsyen pse m'kanë burgosë, dy muj ditë. Kërkojsa. Kur mas dy muj dite po thojnë, "Ali Buzakun e ke qit' në Shqipëri". Ia nisa me qeshë, është natyrë e imja. Po kërkoj ballafaqim. Më marrin mas dy muj dite më çojnë në Prizren në gjygj aty. Shkun ata po bisedojnë. Nja dy milic më kontrollojshin, m'rujshin aty. E kishin pru Ali Buzakun tash po më marrin. E kishin kthy ata kah muri anena, mu po m'shtijnë mrena.

Kta inspektorët e mi po thojnë, "Kthehu Ali", u kthye Aliu. "Kush osht' qiky?" "Ky osht' Muharrem Musliu", "Kush t'ka qit' në Shqipëri?" Tha, "Muharrem Musliu m'ka nxit". Tash mu po m'pysin, "A e ngje ti kta?" Kjo osht' natyrë e imja thashë, "Po qysh s'e ngjoh djalin e tezës", kjo osht' natyrë e imja e bisedës. Thashë, "Po qysh s'e ngjoh djalin e tezës", thashë, "Ali a je budallë?" Origjinal po tregoj. Tha, "Pse?" Thashë, "Hajde mshoj me kokë murit, hajde mshoj me kokë murit", thashë, "unë po të thom dil në Shqipëri a vritesh n'kufi a s'vritesh e unë po rri në krevet në Prishtinë si zotni, a ka logjikë kjo?" "Jo, m'ke bind e knej anej".

Tash, "Hajde me dhanë deklaratë", thashë, "Merre me mend çka po bojnë kta sigurimi shtetnor". Që unë kisha përvojë, kisha nejt me t'burgosur politik masanej prej filmave. Se unë kom shiku shumë filma ktu, sot i shiqoj kah katër filma n'dite. Kemi qenë Avni Zhubi, unë nifar' Bedri Hoxha që thojnë kampion në Prishtinë për filma, në Prishtinë ktu. Tash na la neve dyve vetëm. T'u mendu se e disha që kanë lanë kamera apo ndëgjojsa kanë lanë, ata nuk isha qaq naiv. Isha 43, 44 vjeç.

Hiç s'po du me folë, hiç, hiç, hiç. Veç e kisha kthy kokën qishtu {në anën e majt}. Aliu qaty unë qitu, ni zyre sa qikjo e juja. Hiç s'po du me folë. Çka kisha me folë kur ata përgjojnë. "Hajde me dhanë deklaratë". Dham deklaratë. Mas pesë muj dite më marrin ktu drejt në Prizren në gjygj. Erdh ni...

<sup>2</sup> Ministria e Punëve të Brendshme e Jugosllavisë.



familja ime kishin angazhue avokat, ni të Prizrenit. Tash m'kujtohet emri i tij. Kur e kanë marrë atë n'pytje, Ali Buzakun, mu nuk më lejshin aty. Kur më marrshin mu n'pytje Aliu ish aty. E shifsha që... Engjell Çeta ka qenë avokati im.

Aliu u çojke edhe taketukën atij prokurorit ia shymke. Ai ish në bankë të zezë sikur une tu u gjykue. Tash s'kisha çka me thanë. Ni Sylejman Limani, ni gjykatës e dënoj avokatin tim 15 banka atëherë. Pse po më mbron mue. Ali Buzaku u çu tha, "I kom pre venat në Shqipëri atje se qaq shumë m'kanë mundu i kom pre venat, kom dashtë me mbytë vetën". Prezent ishin aty, kanë qenë mbi 100 vet se shoktë e mi ishin ardhë krejt edhe dajtë e mi po edhe njiherit edhe dajtë e Aliut. Se ai dajë unë dajë.

E disha që e ka kafshu zagari ktu {te venat} te dajtë atje. Për besë t'zotit s'kom pasë, s'kom pasë shpirt me rëndu me thanë, o' Ali pse po rren po kqyr ku i ki dajtë e tu edhe dajtë e mi. Te dajtë t'ka kafshu zagari. Po s'kom mujtë me ra n'pozitë të atij edhe s'kisha mujtë me ra në pozitë të atij. Ni Skender Rugova, prokuror qaq m'ka rëndu mue, qaq ka qenë i pasjellshëm, qaq ka qenë, m'fal n'shprehje i flliqt, s'pata qare, dikur u çova. Thashë, "Ndëgjo prokuror", kanë qenë mbi 100 vet. Thashë, "Ka me të prit 20 vjet, ka me pasë unë ni bisedë me ty". Ju ktheva gjykatësit Sylejman Limanit thashë, "Qita që po i kërcënohem prokurorit merrma si rënduese". Qishtu kjo është natyrë e imja.

Sylejman Limani tha, "E di qysh ta marr". Kom ni që ka ikë meniherë mas luftime, diku në Zvicërr osht'. Tash çka ndodhë? Mu më dënuar tri vjet, Ali Buzakun e dënuar shtatë vjet. M'ishun m'u mbrojtë në liri. Tash mas tri vjete kur po dalim në gjykim... se me Ali Buzakun në Prizren ka qenë Tahir Geci në burg, i dënuar 12 vjet. Ky Aliu si ka tregu, "Kom qenë shofer në Ramiz Sadik, e kom mbytë ni fmi e tash jom në burg". Mirëpo kur jom dënu unë, edhe ka lexu në shtyp ai, Ali Buzakun e kish pasë në dhomë, në burg të Prizrenit, e din. Tash sigurisht ka ndiku ai a diçka.

Mas tri vjete në rishqyrtim Ali Buzaku thotë, "Shok gjykatës çdo gja që kom thanë për Muharrem Musliun kom gënjye", du me qenë fer, jom sportist du me qenë fer, korrekt. "Shok gjykatës, çdo gja që kom thanë për Muharrem Musliun kom gënjye". Gjykatësi qiky Sylejman Limani thotë, "Ali je dënu për shpahunim pesë vjet edhe shtatë vjet dënohesh", "Çdo gja", thotë, "që kom folë për Muharrem Musliun kom gënjye. M'u ka kanos rreziku me më myt sigurimi shtetnor sigurisht", tha, "në krye me Franjo Herleviqin". Kta e ka thanë haptas, para s'disa vetve. Domethonë, "Kom gënjye". Qatëherë m'lirun, mas tri vjete.

**Anita Susuri:** E tri vjet keni qenë në liri a po?

**Muharrem Musliu:** Jo pesë muj n'burg masanej në liri kom qenë.

**Anita Susuri:** E qysh osht' kjo se s'pe...

**Muharrem Musliu:** Ndëgjo, qata që i dënojnë ma shumë se pesë vjet kanë të drejtë m'u mbrojtë në liri. Domethonë, ankohesh në Gjyjin Suprem, nëse Gjyji Suprem ta kthen landën mundësh m'u dënu prap edhe ma tepër se tre vjet, katër vjet ose pesë vjet. Se unë u ankova në Gjykatën Supreme. Në Gjykatë Supreme ju thashë kshtu, "Vërtetone ju ni gjygj", sa isha n'burg, "vërtetone. Nëse i kom thanë Ali Buzakut me ikë për Shqipëri, dënomni vlla edhe 30 vjet ka m'i majtë. Po nuk osht' e vërtetë". Se s'ish e vërtetë. Mirëpo, ata thanë, "68-ten, '75-ten, edhe '79-ten me m'burgosë". E tash Muharrem Musliu po shpëton.

Edhe ishte mas '81-shit, ishte çashtja se '81-shi kur u bon demonstratat e '81-shit në bankë, në Shërbim të Kontabilitetit Shoqëror ku osht' Banka Qendrore u çu drejtori foli, foli, foli, foli. Serb ishte. Tha, "S'ka nevojë kërkush me folë", u çova unë, jom i tillë, u çova. Tha, "Duhet me qenë t'qetë", thashë, "Ku me qenë t'qetë? Kur po shef shumë aeroplana, shumë helikoptera, shumë tenka", thashë, "po sheh edhe shumë ushtar, shumë polici", thashë, "ku mundemi me qenë t'qetë?" Po ju thom, "Armiku i jashtëm nuk osht' i rrezikshëm sa është armiku i brendshëm", thashë, "armiku i brendshëm janë qita që po provokojnë", se ia nisën do serbe, "Qe erdhen tontë, qitash kanë me pa shqiptartë kush janë". Provokojshin. Thashë, "E qita".

Ka qenë ni Milleva Tevoviq, kom punu ni zyre me të po pak. Ajo ia nisi diçka i kom thanë, "*Ćuti tamo seljanko jedna*, Shuj more katunare e keqe" (qeshë), para krejtve ishim qaty. Kjo është natyrë e imja. S'e ka çelë gojën kërkush ma hiç, s'e ka çelë gojën. E tash edhe '81-shin janë çu edhe do shqiptarë, ni Musa Tropoja ka qenë zëvendës drejtori ai haptas ka thanë, "Muharrem ti po indoktrinon t'ritë", kur m'thotë shqiptari pse s'më thotë... edhe shkaku që mos po shpëtoj pa burgosë edhe e gjetën Ali Buzakun. Kom psu shumë, kom psu shumë.

Në qat' kohë m'u pat' nda ni banesë tri dhomëshe. Mirëpo (qeshë) e humba ata. Fminë i kisha, vajzën e kisha tri vjeç, djemtë ishin njëni i kishte gati 15, tjetri 13, tjetri i kishte tetë vjet. S'kish. Shoqja ishte e papunë. Mirëpo tjetrtë janë dënu kah dhetë vjet, 15 vjet, 20 vjet...

**Anita Susuri:** Në cilin vend keni qenë qato tri vjet?

**Muharrem Musliu:** Ktu në Prishtinë edhe në Prizren.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë burgu?

**Muharrem Musliu:** Burgu ktu ma s'pari kur m'kanë burgosë '83-shin m'kanë çu në dhomën tre. Treshi ka qenë n'dhe. Ka qenë ni paravan, ni si shtrat. Ka pasë drrasa. Qishtu drrasat kanë qenë {drejtë} ni mbrojtëse ktu, njo ktu. Fikalli vetëm isha. 34 ditë kom qenë. Duhej me fjet për afërsisht qishtu me fjet {horizontalisht} se me flejt kshtu {vertikalisht} nuk më zejke. Po drrasë m'i drrasë. As shtrojë, as mlojë, hiç, hiç kurgjo, 34 ditë. Isha veç në kmishë edhe do pantollë të verës se ishte 27 korriku. 34 ditë.

Mirëpo mas 34 dite dikush iku, po thom në thojza, iku prej Burgut të Prishtinës, kati i dytë. Në thojza po thom iku, numër 26. Vijnë kah ora... unë po i nij që po bërtasin, “Shaip, Shaip”, Shaip vllau im. Unë tash t’u u dridhë thashë ma paskan burgosë edhe vllaun. Shaip ishte ni zëvendës komandant i Burgut të Prishtinës. Ni njeri pa njeri, ni njeri pa njeri. Janë ardhë veç m’kanë thanë, m’kanë marrë. Kur më çun në katin e dytë dy jogi aty, patos, dy jogi. Po e gjej edhe ni rom. M’shtijnë aty.

**Anita Susuri:** Te qajo ku kanë ikë ata?

**Muharrem Musliu:** Qajo ku ka ikë, qajo dhomë që ka ikë, ka ikë në thojza. Tash po m’thotë ai, ish i Fushë Kosovës ni hajn. Tha, “Kqyr qatje nalt”, po kqyri. Se atje naltë ka qenë ai xhami po me hekur, nalt në krye atje ku hin nitro dritë. E kishin pre ata telat. Njëni ka ikë e tjetri e kanë zanë aty. Kjo osht’ histori n’veti.

**Anita Susuri:** I kemi intervistë tu te dytë ata.

**Muharrem Musliu:** Mu m’kanë çu n’qat’ dhomë (qeshë).

**Anita Susuri:** Çfarë koiçidence, çfarë rastësie.

**Muharrem Musliu:** P’e shoh jog aty. Dy jogi. Tash i prun edhe dy vet për vrasje edhe ai romi aty tre edhe unë i katërti. Tash qita te tre flejshin në ni jogi, mu ma lshun ni jogi. Se mu më merrshin kah dhetë, 15 herë në dite, nër’ pesë herë kurrë s’ka ndodhë në pytje, në hetime. Kta e kishin ni mirëkuptim. Unë në ni qasi jogi, ata katër sa te tre gati në ni jogi, që s’e harroj kurrë. Kjo është me të vërtetë diçka e jashtëzakonshme. Se ju dhimbsha atyne. Tamon më kthejshin prej hetimeve, ndodh që meniherë m’thirrshin tjetër.

Ka qenë edhe interesant që qiky Zymer Zymeri edhe Zoran Dragoviçi zhag m’çojshin për koridori n’pytje. Ka qenë ni Arif Riza edhe ai ka qenë inspektor i sigurimit shtetnor. Po vjen tha, “Muharrem si je?” Thashë, “Mirë shok inspektor”, tha, m’falni shprehje, “Mos ta ninë se kurgjo s’dijnë për ty”, po ju betohna si me m’lshu prej burgut. E disha që s’dijnë mirëpo kur m’tha ky... e tash ai Arif Riza e ka djalë t’vllaut këtë Bekë Rizën që u vra në Kumanovë.

I pari që e ka lshu sigurimin shtetror është ky Arif Riza. Në Prishtinë jeton, kur takohem me të pa e pi ni kafe me të është e pamundur. Se ‘83-shin pat’ guxim me m’thanë, “Mos ta ninë”, tha, “se kurgjo s’dijnë për ty”, guxim jashtëzakonshmit i madh. Domethonë edhe që kanë punu aty ka pasë njerëz jashtëzakonisht t’mirë. Por qit’ Lufti Ajazaj ky ka qenë bishë. Zymer Zymeri ka qenë bishë. Bashkim Kursani ka qenë bishë. E shumë e shumë tjerë atje.

Si hyna ai Lutfi Ajazi po i nxjerrë do pendreka tha, “Me cilin po t’don me t’rreh?” Po s’po du me m’rreh me asnjënin (qeshë). “A me një ma t’gjatë a ma t’shkurtë”, “Burrë i dheut s’ki nevojë me m’rreh s’po du

me m'rreh, pse me m'rreh?" "Jo me cilin se me njënin po po me cilin?" E patën plagos tont po iku në Kurshumli atje. Ka punu atje mas lufte. Para nja dy vite ka vdekë, e kanë vorros ktu në Drenicë po qe tri-katër herë po ia prishin vorrin.

Qito prralla tona të burgosurve politik që a jemi mundue diçka me mbajtë zjermin ndezë. Hun, hun që thojnë, hun e din çka osht', ai druni që digjet me mbajtë ndezë. Kah kemi shku e kemi propagandue për çashtje kombëtare. Ka qenë koha e tillë, sot nuk osht' ma kjo kohë për qato gjana. Mirëpo sot s'i kem puntë mirë por për kta s'du me folë, për kta nëse doni me folë fol tash ose naj herë tjetër ose diçka që jom i befasun për t'keq.

### Pjesa e Pestë

**Muharrem Musliu:** Demonstratat e vitit '68 kanë qenë autoktone, tonat kanë qenë, na i kemi organizue vet tont. Pa ndihmën e asni sigurimi, as Shqipërisë, asni sigurimi tjetër. 1981-shin ka pshtjellime t'mdha. Kanë qenë 40-50 sigurime t'jashtme. Bullgar e gjerman, e rus e serb e gjithkah kanë qenë. Ajo ka qenë... qato t'mira që na pat' pru 1968-tsha na pruni Kushtetutën e '74-tes, që ka qenë ni fitore shumë e madhe. '81-shin gati i humbëm krejt.

**Anita Susuri:** Ju '86 po i bjen keni dalë prej ktuhit?

**Muharrem Musliu:** '85-ten.

**Anita Susuri:** '85-ten. Qysh ka vazhdu pastaj, a keni mujtë me ju kthy punës?

**Muharrem Musliu:** Po, po se u shpalla... Gjygji Suprem më shpalli të pafajshëm. Çka osht' interesant ish që ky Musa Tropoja zëvendës drejtori se drejtori serb ishte në spital. Ruzhdi Mjekiqi ishte këshilltar i pavarur, gjallë osht'. Nuk dojshim me m'pranue. 'Po na indektrionin t'ritë'. Osht' e vërtetë që krejt çka janë pranu t'ritë te unë kanë ardhë, me vajza, me djem e krejt se isha ma i vjetri. Besojshin krejt te unë, osht' e vërtetë. Sidomos Shkollës Ekonomike që vishin në praktikë, vishin te unë m'i msu me ua shkru ditarin me ju shpjegu edhe m'i ia nënshkrue ato fletoret e krejt.

Unë shkoj në qendër tonë. Ka qenë ni Leonid Nikoliqi, zëvendës drejtori ai ka qenë vllah cinciar, me cilin kom lujtë futboll. Ai tha, "Shko filloja punës". Unë vi prap në zyre ktu ata s'më pranojnë, prap unë shkoj atje. Dul ai drejtori i përgjithshëm ni Sfeto Vukoviqi. M'falni. Tha, "Muharrem", tha, "ti s'je punëtor i jonë, ti shko në filja", tha, "hin n'zyre edhe puno. Ti je shpallë i pafajshëm ti hin n'zyre edhe puno". Jom çu jom ardhë drejt kom hy n'zyre. Ia kom nisë punës.

Tash kta dy janë çu janë shku në qendër tonë atje me pytë nifar' Marseniçin, ka qenë jurist. Ai Marseniçi thotë, "A jeni normal? A ka thanë drejtori gjeneral shko n'punë, çka po doni ju?" Shqiptarë ishin ata.

Sot osht' Ruzhdi Mjekiçi gjallë. Qiky Ruzhdi Mjekiçi mas luftës del n'penzion se ni shok i jon shkron zëvendës kryetar ktu në Obiliq, Hajriz Bekteshi. A din çka i kish pasë thanë Ruzhdiut, "Muharremi na shqiptartë e kemi pasë jorgan, na ka mbulu t'gjithëve". Po ai ka shku n'komitet kundër meje, në komitet ka shku kundër meje që po indektrioj të ritë shqiptarë. Pse? Se e kom folë veç për çashtje kombëtare.

Qata që na kanë... kanë pasë kta gjithkrah bashkëpunëtor. Në çdo, çdo pore kanë pasë bashkëpunëtor. Mirëpo unë i kom pasë zbulu do te na edhe po ju tregoj haptas. Portirat shqiptar, e disha që portirat janë gjithkrah, kanë bashkëpunue, në përgjithësi po foli. Kur fola prej burgut shkova në zyre në katin e tretë, i kqyra do dokumenta do diçka.

E mora ni letër të bardhë edhe e coptova dhe e shtina në xhep. Shkova po ia shti në xhep atij portirit, "Qite", thashë, "n'kat t'parë lshoje në novojtore lshoja ujin se po m'përcjellin". U çu meniherë n'vend se me thanë Muharrem pse ti s'e ke lshu atje. Po ju betohna e kemi përcjellë, e ka përcjellë qiky Hajrizi, ka shku drejt në SUP, në milici atje e ka dorëzu. S'ka pasë asni shkronjë, totalisht letër e bardhë ka qenë (qeshë). Se ata kanë lujtë me neve edhe ne jemi mundu me lujtë me ta.

**Anita Susuri:** Po du pak me folë edhe për, folët për aktivitetin politik po përmendet filmat. E dijmë që ktu në Prishtinë ka qenë Kino Rinia, ka qenë...

**Muharrem Musliu:** Kino Vllaznimi.

**Anita Susuri:** Po. A mundeni pak për qit' jetën kulturore pak me folë?

**Muharrem Musliu:** Jeta kulturore ktu filmat kanë qenë në përgjithësi në përgjithësi, se Kinema Rinia ka pasë edhe sallën jashtë edhe mrena edhe Vllaznimi ma vonë. Mirëpo unë ia kom fillu Kino Teka. Kino Teka ka qenë nifar' cubi, ni rom punojke ka qenë dikund pak ma poshtë se që osht' busti i Skënderbeut atëherë. '48-ten aty ka qenë. Si fmi ia kom pasë fillu me shku nëpër kinema. E kur u bo Kinema Rinia ka qenë... dy herë n'dite shkojshe.

Se s'ka pasë... ose me shku në qato ballot që thojshin *igranka* kta. Aty ku shkojshe në përgjithësi serb edhe femna serbe. Femrat tona s'kanë shku asnjë as viteve '50-ta, '60-ta, '70-ta s'kanë shkue. Shkojshe serbët edhe ndonji shqiptar rrallë ndonjë shqiptar ka shku. Na kishim ose orë letrare, normalja sidomos kur majke ose në gjimnaz ose në kinema. Rregullisht unë kom qenë i parapaguen n'film deri vitet e '80-ta, '50-ta, '60-ta, '70-ta deri viteve '80-ta.

Se shkojshe filmat, për shembull, kur shkojshe me qit' Hilmi Rakovicën kur ishin amerikan edhe indian. Krejt rrehshe dorë kur fitojshin amerikanët që i mujshin indianët unë e Hilmiu për indian se e dishim që ata kanë qenë vendas. Në mënyrë ma të sinqertë po ju thom. E dishim që ata janë vendas. E

na e krahasojshim kta. Jusuf Gërvalla ka qenë kritik i filmave edhe shkova niherë n'zyre në dyqan të Sabri Novosellës, p'e shoh edhe Jusufin aty.

Tash po bisedojmë tash Jusuf Gërvalla... se Sabriu po i thotë, "Muharremi shkon rregullisht n'filma". Tash po m'pytë Jusuf Gërvalla tha, "Muharrem", se patën ardhë '71-shin do filma prej Shqipërie patën ardhë, 'Komisari i Dritës', 'I tetë në bronz', 'Pajtimi i një hakmarrje', do filma. Unë i pata nxjerrë nja 18 bileta i mora mes Shërbimit të Kontabilitetit. Me Metush, me Hyrije, me Ahmet, me Xhafer, unë e krejt. Krejt na rreshtin e kishim ish t'burgosurit politik aty (qeshë).

Tash po m'thotë me bo ni krahasim Jusuf Gërvalla. Thashë, "Jusuf, filmat amerikan janë të inxhizun jashtëzakonisht mirë, teknika ka shku shumë larg dhe i shtjellojnë jashtëzakonisht mirë. Ndërsa filmat tonë e shtjellon ni rast mirëpo ndërpritet e del n'tjetrin menihere. Mirëpo kur osht' n'pytje çashtja", po i tregoj, "në ata filma s'më kanë dalë lot, në filmat tonë po m'dalin lot".

E mora si shembull, 'Komisari i Dritës', kur e lshon shkollën ai plaku, s'e di nëse e keni pa, msusi shkollën, shtëpinë e vet edhe të gjyshit t'vet e bon shkollë. Tash a s'kishin ku m'u ulë po do shkom. Shkon osht', e dini, me tri kamë edhe do uleshin poshtë në tokë. Qashtu e kishin bo. E tash nuk po gjejnë zile (qan). Tash ky plaku, gjyshi, po shkon po ia hjekë kumonën dhisë edhe po merr po i thrrret nxanësit. S'ka pasë që s'kemi qajtë. Tash po m'dalin lot, m'falni (qan).

**Anita Susuri:** Pini pak ujë nëse doni.

**Muharrem Musliu:** Jo, jo, jo. Po janë momente që... edhe po i tregoj Jusufit qishtu. Masanej, 'I tetë në bronz', se e dojshin njerëzit Enver Hoxhën. Pa e njoftë na kha hiç e dojshin. Në Kinema Vllaznimi po lun 'I teti në bronz', kur ai rolin kryesor që kish n'fund p'e merr bustin e Enverit edhe po ecë, a din. Kta krejt shuplakë rrehsin. Ose filmin 'Skënderbeu' kur e kemi pa në Vllaznim, herën e parë me pa flamurin kombëtar, haptas.

Se na shumica që kemi qenë, që kemi pasë familje NDSH e kemi ditë, kemi thanë, "Kuç e zi edhe me shqiponjë n'mes". Kuç e zi, kuç e zi. Shumica s'e kanë ditë. Herën e parë qitu në Prishtinë kur ka lujt filmi 'Skënderbeu'... filmin 'Skënderbeu' Rusia e ka inxhizue, jo Shqipëria. Kur ka dalë ai me flamurin e Skenderbeut, krejt salla n'kamë (qan). Kto janë momente që janë regjistruar te na, kanë mbetë në kujtesën tonë si momente të paharrueshme.

Mirëpo gati ma shumë individuale, familjare deri në '99-ten. '99-sha ka qenë tmerr, ka qenë tmerr '99-sha. Kush ka, kush osht' i fortë që ka qenë ktu në Kosovë ose që ka qenë n'luftë ose që ka qenë jashtë, kto përjetime nuk osht' lehtë m'i shpjegue. Isha qaty në Ulpianë, i hyni, unë isha në katin e dytë në katin e katërt i hyjnë në banesë qita para militarët po i thojnë, se ata kanë qenë njësi speciale. Vajza e tij edhe reja e tij ikin diqysh e vijnë te na. Po na tregojnë thanë, "Kanë hy", qata paramilitarët, m'i mytë. Me kërkun pare, ishte maj.

Na u veshëm krejt se e kisha edhe vllaun. Vllau kishte pesë vajza, unë e kisha djalin, vajzën edhe ren. Dy djemtë i kisha jashtë. Atë natë gjithë natën na veshun, kanë me hy edhe neve me na mytë. Bedri Keqës, doktorit, edhe nesër kah 06:00 t'mëngjesit ato vajza e Bedriut dhe reja, ato veç t'u qajtë t'u mendu që ia kanë mbytë krejt familjen. Çohen shoqja ime, kur shkon i gjon qut. Ata ditë hiç ku e ka Bedriu vajzën edhe ren. Kur ju thojnë që janë te na, na për shembull... ka qenë tmerr ktu në Prishtinë.

Nuk guxojshim shumë me dalë nëpër qytet. Kur takojshim sidomos... mu po më thrrasin në maj se kom pasë ni vend t'punës në Shërbim të Kontabilitetit që s'ka ditë kërkush me krye pos une (qeshë). Drejtori Marko Privica m'thrrret me telefon. "Muharrem", tha, "a po vjen?" Ish maji i '99-tes. Tha, "Se ka mbetë puna jote llugë", thashë, "Po vi". Haptas i kom thanë po vi se neve na lshun krejtve, na dhanë kah, me 30 prill na dhanë kah dy muj ditë na dhanë pushim vjetor. "Shkoni nëpër shtëpija". Thashë, "Po vi". Mirëpo ni punëtor i imi shkon i thotë drejtorit, "Nëse vjen Muharremi", thotë, "ka me t'vra edhe ty edhe Muharremin", serb. Se unë shkova. Thashë, po shkoj. Nuk m'lanë se deshti me m'vra ai.

**Anita Susuri:** E ju krejt vitet e '90-ta keni punu? S'e keni nalë?

**Muharrem Musliu:** Jo te na asnjë s'e kanë largue. Ka qenë ni drejtor i Lapllasellës ni Stanimir Steviq masanej erdh Marko Privica. Marko Privica as malazez, asnji s'e ka largue. Në filalë tonë asnjë s'e ka largue hiç. Pse? Malazezët edhe serbët ia kishin inati. Mirëpo ky malazez. Rregullisht u konsultu me mue, rregullisht. Ky edhe Vojadin Koperivica ka qenë kshilltar, e nifar' Deniç Bane ka qenë kryesor në kontroll. Ata tre kanë qenë kryesor viteve të '90-ta.

Ata u konsultojshim me mu se kom qenë fer, korrekt, e kom njoftë punën. Por e kanë ditë që s'ka mujtë kurrë kërkush n'jetë me më korruptue, ata e kanë ditë. S'ka ekzistë. M'kanë besu. Pamarrë parasysh që e kanë ditë që jom nationalist numër ni, po m'kanë besue. U konsultojshin. Se kur u bo ajo që shkum në greva me 02, me 03 shtator m'duket unë kom qenë pushim mirëpo t'nesërmen shkova.

E tash po shkoj te drejtori po i thom, "Dëgjo, ju na largoni prej pune", a keni shqiptar ktu shumë interesant, kur te largojnë dikond prej pune shkojnë njerëzit me pa. "Tash p'e za vijnë 30 vet te unë, 30 vetve duhet me ju thanë Stanimir Steviçi m'ka qit' prej pune", thashë, "e qata 30 vet ju tregojnë edhe 30 vetve e krejtve". Tha, "Muharrem ty po të tregoj, çka janë me shkollë t'mesme ktu kom me i dënu veç 5%. Kta me shkollë t'lartë 10% po mos i trego kërkujt". Edhe s'i kom tregu kërkujt.

Kur po shkoj tash që me marrë n'pytje ai juristi e dijkë që unë e di. Kemi folë për sport, për futboll. E disha që kanë me na dënuë. Marko Privica asni nuk e ka largu hiç, hiç, asni s'e ka largue prej pune. Shkova rastësisht, po dal prej teme n'temë, po shkova rastësisht, jo rastësisht po m'çun në Pejë në Shërbim të Kontabilitetit me ju ndihmue. Atje ishte ni Dragani drejtor. Djalin e Draganit e kanë vra në atë rastin Panda. Djalin e Draganit. Ata gjashtë që u vran.

**Anita Susuri:** Po, po.

**Muharrem Musliu:** E tash po m’thotë ai Dragani, po nuk bisedojshim për djalë t’tij. Po m’thotë, “Muharrem shqiptarët asni s’i kom largue. Thuju le ta formojnë ata sindiaktën e vet po t’mos largohen prej sindikatës tonë se m’u largu prej sindikatës tonë duhet me i largue. Po ata le t’japin pare çka dojnë e le ta formojnë sindikatën e vet, nuk ju pengoj. Mirëpo mos t’hiqen prej sindiaktit tonë”, shumë fer, shumë korrekt. Asni s’e ka largue.

E ka qenë ni Shosheviq Sllobodanka në Ferizaj, ni, m’falni n’shpërheje ni magjupe me t’cilën unë prej ‘75-tes me to s’kom pasë folë (qeshë). Sa ka qenë drejtor atje e kom pasë... Ajo i largojke. I largun në Gjilan, i largun në Mitrovicë. Mirëpo do nuk kanë largue. Te ne asni nuk kanë largue, asni hiç s’e kanë largue. Mu m’ranë 40 e sa vite punova në Shërbim të Kontabilitetit. E disha që osht’ shpija ime e dytë, jom interesue shumë. Për çdo ditë ‘99-ten jom shku m’u interesu, kom kalu asajde.

Me 14 qershor, me 12 hyni NATO-ja. Me 14 qershor jom shku te drejtori, Marko Privicës, i kom thanë, “M’i jep çelsat e ndërtesës prej sotit ndërtesën, bankën unë e menaxhoj”, tha, “Qe çelsat Muharrem”, se ata natën s’guxojshin me nejt. Tash i mora çelsat edhe atë natë shkova me rujtë me djaltë e mi jom shku me rujtë. Qendra ku osht’ Banka Qendrore me djalë timin kom shku e kom rujtë atë natë.

T’nesrit i thirra do çka ishin në Prishtinë, çka kishin mbetë. Ka qenë Qefsere Hatashi, ka qenë Sherafedin Kulinxha, Afërdita Spahiu. Ka qenë kjo Fahrije Dragusha. I thirrsha me ardhë ditën me ardhë me rujtë, natën rujsha une. Kjo ishte me 14.06. Me 16.06 e thrras ka qenë shefe kjo, shumë interesant, shefe e arkës së trezorit ni Popoviç. E thrras unë, tha, “Jom në Nish”, thashë, “Ku janë çelsat e trezorit?” Trezori p’e dini çka osht’ (qeshë). Tha, “Janë te Vishnja në Graçanicë”. Unë ni taksi e drejte në Graçanicë, me 16.06.

Shkoj te Vishnja, thashë, “Vishnja, kanë ardhë paret prej Bankës Popullore të Beogradit”, kjo osht’ as andërr njeri me pa jo. Po e qita qata. S’e si t’i thom prej Bankës Popullore të Beogradit... thashë, “Kanë ardhë paret prej Bankës Popullore të Beogradit merri çelsat e hajde me çelë trezorin”. Ajo mendojti që osht’ e vërtetë. Ku me ardhë me 16 ishte, ishte... vjen. I marr çelsat e çelim arkën e trezorit edhe bojmë regjistrimin e arkës së trezorit.

Te na ka qenë aty llogaria 100, qashtu ka qenë arka e trezorit. I marr ni Filipoviç, Filip serb, Sabedin Shujaku edhe Hysni Rudi. Thashë, “Bomna komplet regjistrimin e arkës së trezorit”. I gjetëm kah 13 milion e 8617 e diçka dinar. Domethonë s’e kishin prekë, s’e kishin prekë, s’kishin marrë kurgjo. Ni veturë na kanë marrë se kurgjo s’i kom leju ma me marrë. Krejt qysh osht’ në Bankë Qendrore aty ShKSh-ja. Masanej me qata 13-14 milion i thirrshim firmat që kishin mjete edhe ua kemi dhanë krejt.

Masanej erdh UNMIK dhe e pruni ni anglez ma së pari drejtor. Unë shkova dy-tre vena se i kisha autorizimet prej qasaj qeverisë së përkohshme, me zgjedhë nja dy drejtor. Ishin mbetë nja 40 serb



ishin mbetë aty. Tash ata kërkoshin që unë m'u bo drejtor, isha me shkollë t'mesme, m'u bo unë drejtor. M'thirri edhe drejtori prej Bankës Popullore të Beogradit, se më njofshin. Tha, "Muharrem bonu ti drejtor", thashë, "Jo unë drejtor s'bohna".

Ia fillun krejt me kërkun ndihmë prej meje që kto serbët edhe serbet, 'Ndihej se po na marrin banesat'. Po ju thom, "Po ju s'na keni ndihmu neve asnjë", "E na nuk jemi fajtor, shteti osht' fajtor". Çka osht' kjo? "Na s'jem fajtor po shteti". A te na unë t'garantoj për qita edhe pikë. Ata kurrë nuk kanë garantu për kërkë hiç. "Pse bre", thojsha, "ju s'na ndihmut?" "Nuk jem na fajtor, shteti osht' fajtor".

Ju thashë... se i kisha qato autorizime. E zgjodha unë ni drejtor. I thashë ni Muharrem Ukës, "Bonu ti drejtor". Qitij Hysni Rudit i thashë, "Qe ti çelsat e arkës së trezorit, ti je shef prej sotit". Atyne serbëve krejt ju thashë, "Prej sotit e keni kah ni muj pushim vjetor me pagesë", krejtve ju thashë. Ua dham vendimet që kah ni muj ditë pushim vjetor me pagesë. Shkun, asnjë s'u kthyen (qeshë). Se e lufta këtë lojë se jom i lindun për kto gjana, e lufta këtë lojë.

E kom ditë komplet mjetet kah po shkojnë viteve të '90-ta. S'osht' kjo për juve me ju tregu po s'erdh kërkush m'u interesue deri 2007-ten që kom dalë në emision. I kom pasë shiritat, traktat ato të rrumbullakëtat për krejt filialat e Kosovës. Se m'i bishin mu se isha kryesori për mjete për krejt. Kurrë s'ju ka interesue me ardhë m'u interesu kah kanë shku mjetet, sa kanë marrë mjete, sa s'kanë marrë. Kërkush s'i ka ditë ma mirë se unë, kërkush, sot e thom, haptas. E dijnë edhe shoktë.

Kom ditë përafërsisht prej '92-she krejt kontributet çka janë pague. Se rroga dhe kontributet janë 51 me 99. Domethonë nëse ki m'i marrë 100 euro rrogë, 51 i ke marrë a 49 kanë shku kontribute, tatime. 1993 krejt qato tatime që kanë marrë punëtorët tonë që kemi qenë kah 300-350 mijë të inkuadrin në Kosovë, kanë shku në fondin e luftës të Serbisë. Nuk intereson askush me ardhë hajde ta pyesim bre qat' Muharrem Musliun. Se e dijnë. Se i kom ngjofte me mjek, me profesora, me... krejt kuadrat i kom ngjofte qitu edhe m'kanë ngjofte. S'ju ka interesue. 2007-ten qato, s'i i kom pa qato shirita i kom gjyjtë, i kom përplas, i kom qit' n'kontinjer.

**Anita Susuri:** Deshta me ju pytë edhe n'vitin '90 që ka fillu Pajtimi i Gjaqeve, thatë që keni qenë atje...

**Muharrem Musliu:** Po, po. Unë kom qenë edhe ma herët se m'ka ngjofte kta pjesa e Gollakut që i thojnë. Gollak i bjen prej Orllanit, Batllavën e dini ma mirë, e gati te Presheva knena. I kom ngjofte do katune m'kanë ngjofte, kom shkue. Mirëpo viteve '90-ta isha edhe në federatë edhe u njifsha me kta. Me Profesorin Anton Çetën, me Bajram Hotin, me Musa Limanin, me Profesorin Kajtaž Recaj. E kom pasë edhe profesor dy vjet në gjimnaz. Ishin Mujë Rugova, ishin krejt kta. Masanej disa knej kah Gollaku unë i organizojsha në Mramor e në Marec e Dabishevc e. Se i kisha t'ngjofshëm edhe i njifsha ma mirë.

Shkojshim nëpër qito pajtime. Masanej kemi qenë edhe nëpër Drenicë e gjithkah. Ka qenë, ka qenë lodhje e madhe. E di që na pritshin s'disa vena na pritshin policia edhe na përcillshin. Niherë t'u shku

në Mramor e dijmë që n'qat' shpi që shkojshim nuk ish bash e pastër po tham po shkojmë le t'na çojnë sa dojnë n'burg. Se kishim me pajtu ni familje t'mirë me ni familje t'keqe. Mirëpo familjes t'keqe, familjes vrasëse kurrë s'i kemi shku n'shpi, kurrë kafe s'kemi pi. Kurrë hiç.

Masanej, te na ka qenë ligj qat' këshillin qendror për Pajtimin e Gjaqeve që na kemi shku m'i pajtu, jo m'i ndreq. Jo me kushte. Jo me lshu katunin, jo me pare, jo me besë, jo me... jo, jo, pa kusht. E kta që ia kanë fillu me kushte, kta, kta ndreqin njerëz, na kemi shku me pajtu. Folshëm në emër të rinisë, në emër të zotit, në emër të luftës, në emër të kombit. Qito. Njerëzit... ka qenë diçka e jashtëzakonshme.

**Anita Susuri:** A keni pasë ndonjë rast specifik që ju kujtohet?

**Muharrem Musliu:** Ka qenë ni kah Bellopoja, kah Llapi, tash më kujtohet emri. Ia kishin vra dy djem n'rrugë. Gati pa kurgjo hiç. Edhe s'pajtojshin. Çohemi shkojmë na, ish edhe Musa Tropoja, Musa Limani profesori. Ishte edhe me neve njëni n'autobus. Ai na përcillte çka po flasim. Tash po pytum, "Ku e ka Shaban", tash m'kujtohet edhe mbiemri, se ni mbiemer e ka karakteristik se kaniherë po harroj, 83-84 vjet. "Shaban Kuleta, ku e ka shtëpinë?" Tha, "Unë ju çoj", tha, "pritni qitu". Na po presim para dere. Ka hy tjetrën derë, erdh na çeli derën (qeshë).

Po na shtin mrena. Tash p'e shofim na. Musa ka qenë ma transparenti prej nesh, Profesori Musa Limani. Tha, "Mirë bre djalë", tha, "ti?" Tha, "Unë jom djali i Shaban Kuletollit", tha, "Po pse s'na tregove?" "Kisha", tha, "dëshirë me ditë çka folni ju. Kur jeni veç ju" (qeshë). Hyjmë atë natë aty, dikur ky Musa po i thotë, "O' Baca Shaban", tha, "Fol profesor", tha, "A po m'i falë dy djemtë t'i dalë shkaut n'gardh?", gardh e din çka osht'?

**Anita Susuri:** Po.

**Muharrem Musliu:** N'kufi. Tha, "Po bre profesor", tha, "Jo qita dy që i ki gjallë po qata dy t'vdekurit". T'nesrit në Lluga gati 13 ngatërresa, gjaqe u pajtun masi e fali Shaban Kuletollit. Domethonë ky ka qenë rast kur din s'i m'u sjellë. Tha, "A po m'i falë, p'i dalë sante shkaut n'gardh, në kufi?" Tha, "Po, po t'i fali", "Jo kta dy që i kie po ata dy". Osht' dashtë njeriu ka qenë edhe Mulla Idrizi n'atë mënyren fetare, sidomod kah Presheva. Niherë kemi qenë në Miratovc atje te Presheva. Ata fetar t'mdhaj, a din. Mulla Idrizi kishte, me kuran e kto gjana. Kur folke ata habiteshin. Ka pasë edhe momente tjera po janë do momente që, janë t'prekshme, të ndishme.

**Anita Susuri:** A e dini përfarësisht n'sa familje keni qenë ose keni pajtu?

**Muharrem Musliu:** Po janë pajtue kah dy-tre mijë vrasje. Veç janë gati, pjatesa janë mbi dhjetë mijë. Ngatërresa, pajtesa e kto kanë qenë. Kanë qenë shumë. Shkum niherë na në Marec ishte edhe profesori. E mora unë edhe ni Sejdi Kryeziu të Roganës, Rogoçicës atje edhe ishte ni Rrahim Kosova. Rrahim Kosova në Francë ai e ka pasë t'ndalune me ardhë në Kosovë. Ka qenë NDSH-ist ka vra ktu. E ka

thy burgun në Jugosllavi, ka ikë. Nejse, ka shkru ni libër, ni shkrimtar shqiptar e përmend Rrahim Kosovën, Redenica.

E mora edhe unë ata. Ai kishte vlla atë që kishim me falë në Marec po ata t'ardhun prej Hogoshtit. Ai kishte musteqet deri ktu {tek mjekrra}, vllau i ktij Rrahimit. Tash, po çohen ata po thojnë, "Po ju falëm derisa të shlirohët Kosova". Na kushtet, thashë, s'i kemi pranue. Profesori po çohet n'kamë po thotë, "Jo, kjo s'osht' pajtesë, nuk mundemi me pranue këtë pajtim. Ose duhet me falë m'u pajtu përgjithmonë ose"...

Tash ky Rrahimi ma i vjetri e ka thirrë vllaun e vet, i thojshin Bubi. I ka thirrë edhe nipat e vet. E ka marrë edhe Sejdi Kryeziun. Se Sejdi Kryeziu kish qenë në burg të Idrizovës në Maqedoni, bashkë kishin qenë. Tha, "Çu vlla". Shkon i shtin mrena n'dhomë (qeshë), n'dhomë te gratë atje. E ka hjekë revolen, e t'ju mshon kresë vllaut t'vet e nipave t'vet e t'i përgjakë. Thotë, "A din m'ka ardhë krejt Kosova m'kanë ardhë", thotë, "e kom Profesorin Anton Çetën ktu, ju po doni me m'korit".

T'i kish pasë rreh. Kur u ardhë, ai Bubi që i thojshin, vllau i Rrahimit, kur u ardhë musteqet krejt t'përgjakta huntë. Erdh tha, "Falë ju kofshin, u pajtum". Kur dulë po ia bon Antoni, "Çka bone Rrahim?" Tha, "Pata m'i vra po Sejda s'më la", vllaun e vet e kta. Janë do raste që të pa imagjinueshme mirëpo t'vërteta.

**Anita Susuri:** Thatë që vitet e '90-ta, ju vazhdimisht keni punu kur ka qenë ni situatë shumë e tensionune në Prishtinë...

**Muharrem Musliu:** Në Prishtinë ka qenë shumë e tensionune po isha unë edhe në Federatë të Futbollit të Kosovës edhe e kisha vendin e punës që... se ShKSh-ja ka qenë ent shtetror. Si i thojsha, "*Inspektor u SDK*", ndryshe, krejt ndryshe më shikojshin. Mirëpo nuk na ngucshin se lujsim nëpër livadhe, nëpër ara. Fushat na morën krejt. Veç Fushën e Flamurtarit ktu e lanë. Lujsim nëpër ara, nëpër livadhe edhe nuk na ngucshin.

Situata ka qenë në Prishtinë viteve '90-ta deri '96, '97 lirisht mujshim me dalë. '97, '98, '99 veç, s'po di si me thanë, veç kemi guxu me dalë prej Hotel Grandi ku osht' deri te ata sermaforat aty kryesor. Qikjo pjesë. Knena s'guxojshim kërkush me dalë. Po çka ndodhi? Lagja e Muhaxherëve, Pozerka që i thojnë Lagja e Pozerka, edhe Kodra e Trimave atje krejt i hapën muret, i bojnë sokaxhik, kapixhika. Kapixhik i bjen turqisht derë e vogël, derëz, kapi derë edhe kapixhik.

Domethonë i çelën me dalë prej shtëpisë tane dilshe n'krejt lagjen atje pa dalë n'rrugë hiç, pa dalë n'rrugë i çelën. Sidomos Lagja e Muhaxherëve dhe anena Kodra e Trimave. I çelën shtëpijat. Domethonë lëvizishin nëpër shtëpija. Prej shtëpije... edhe kush nuk ka thanë pse po m'hyn nëpër oborr ose diçka, pse po ma then murin ose diçka. I patën thye, qashtu ka qenë jeta. Mirëpo janë vra ktu

në Prishtinë, për shembull, e kanë vra ni kusheri timin. Tash qatje te bunari i Hajratit del baba i vet i sulmon ata, ‘Pse ma vratë?’ E vrasin ata. Në oborr i kanë vorros.

Ktu ku isha në Ulpianë unë në ndërtesën S12 nën rrugë aty meniherë, në ndërtesë t’parë vdes ni gru edhe shkon shoqja ime e ka la, e ka la, për nder. Ishin pesë vajzat e vllaut edhe vajza ime. Thojshin, “Jo ti duhesh me shku diku në hamam me të tushirat se s’guxon me hi ktu”. Shoqja ime u shku e ka pastru, e ka la dhe e ka përgatit, s’kish kush, s’guxojshin. Veç vishin do magjup me kerre i çojshin nëpër gropa, nëpër qito. Ka qenë kohë pa kohë. S’guxojshin me dalë t’ritë kërkund. Mirëpo kjo organizata ka punue në Prishtinë, e luftës, ka qenë ktu.

E vran, për shembull, këtë te konviktet atje këtë llapjanin që e vran gjatë kohës së luftës. Para tij djali im, janë betu në Lagje të Muhaxherëve 200 vet. Ka ekzistue sidomos kha naltë kah kisha që shkojmë përpjetë atje, Rruga e Bledit ajo edhe Rasim Kiqina. Atje kanë nejtë gjithmonë kanë nejtë kta të ushtrisë tonë. Mu m’ka ra me çue ndihma dy-tri here. Niherë shkum me këtë Hajriz Bekteshin edhe nifar’ Ferati me çu në Zllashë. Ish, Zllashi është kapun me Mramor edhe me Marec atje. Na nalën nja dy milic na nalën në Slivovë te rruga aty.

Dola aty thashë, “Jom i Marecit, m’ka dekë ni axhë edhe po shkoj n’vorrim”. Po hy, tash po hy ni lokal po blej do sheqer edhe do çaj. Thashë, “Se osht’ rregull me çu sheqer, e çaj”. Na kishim tjetër sen me çu me veturë. Tash ish ardhë milici mrapa meje. Unë po i thom asaj shitëses, ishte ni shitëse, thashë, “Ndëgjo, nesër masneser ka me ardhë me ju kontrollu juve se s’pe dorëzoni pazarin në ShKSh”, në Shërbim të Kontabilitetit. E lujta këtë lojë, se... ai milici tha, serbisht po m’thotë, “Unë marrë vesh kah pak shqip a e din?” Thashë, “Po, po ka me dalë zyrtarisht nesër e masnesër krejt nëpër kto katune”.

Çum atje ndihmë tash kah u kthym anej prap thashë, “Prap po na nalni neve na”, edhe na Ishun. Kemi çu atje me Hajrizin dy-tri here. Në Drenicë kom qenë, çojshim ndihma qishtu. Po unë relativisht mirë kom kalue. Pos qatij burgu. Thashë, në federatë qaty i kom organizue t’gjitha ndeshjet. Vitin 2000 e Ishova Federatën e Futbollit, i bona 60 vjet. Mbeta n’punë qaty. Vjet m’thirri ky Agim Ademi që osht’ kryetar i Federatës Kosovare të Futbollit ma dha ni orë dore për 60 vjet n’futboll. Ma dha ni mirënjohje, që jom shumë mirënjohës. Për mu është shumë punë e madhe kur dikush ta çmon, ta respekton mundin që kemi dhanë qata.

**Anita Susuri:** Masi jeni penzionu, a keni vazhdu me futbollin?

**Muharrem Musliu:** Jo hiç, e kom lanë. E kom lanë ia kom kushtu vetit. Dal në Gërmi shëtis. Dal me shokë rri qaty, jem nja pesë-gjashtë shokë rrijmë rregullisht bashkë. Shëtisim, dalim. Shkoj në Gërmi rregullisht, eci dhjetë, 15... tash zakonisht ni shok që dilsha me të se m’kanë vdekë shoktë, gjenerata ime, m’ka mbetë veç ni Mustafë Breca me t’cilin kom qenë në gjimnaz bashkë edhe kemi punu bashkë e kemi lujtë bashkë futboll.

Po atij... ky 1962-shit ia theu kamën ni Bora Gërkoviçit, vllaut t'ni heroit të Trajko Gërkoviçit që osht' edhe në fabrikë atij. Ia theu kamën qitu në Prishtinë me qëllim se ai ia pat' thy ni dhom atje (qeshë). E dënun për jetë. Me të kom dalë në Germi deri para katër-pesë vjete, tash nuk osht' mirë me shëndet, ai nuk po del. Unë dal rregullisht. Jom i lëvizshëm ende, jom aktiv n'jetë. Dal me shokë rri edhe që gati 84 vjet i boj në 01 janar.

Mirëpo praktikisht n'shoqni jom gjithmonë i disponuem, gjithmonë jom n'gjendje me pranue, inatin s'ja kom kërkuj, s'e urrej kërkond. S'foli për inati kurrë për kërkond s'foli për inati. Ju thom shokve shpesh, "Unë e di për ty ti thuj çka dush për mu, unë haptas thom, hiç pesë pare s'i japi". I respektoj shoktë, i thrras. Kjo osht' jeta e ime.

## Pjesa e Gjashtë

**Anita Susuri:** Nëse doni edhe diçka me shtu për fund?

**Muharrem Musliu:** Po s'po di çka kisha me thanë për fund. Nuk jom anëtar i kurfar' partie, tregova, s'kom qenë kurrë. Qaty jom përzi me kta të NDSH-së mirëpo ajo pari osht' e kohës, ka qenë parti e kohës. Nuk osht' e kohës së sotshme. Janë qito parti politike që m'vjen shumë keq. Në Amerikë i kanë dy parti politike. Në Maqedoni, maqedonët, bullgarët, maqedonët i kanë dy parti politike LSD-në edhe VMRO-DPMNE. Shqiptartë tonë 32 parti.

Befasia ime ma e madhe osht' që dalin n'kuvend, nuk flasin për çashtje kombëtare, s'flasin për çashtje ekonomike po vetëm t'u akuzu njëni-tjetrin, t'u e sha njëni-tjetrin. Pse masanej te unë për shembull n'jetë time nuk ka pasë njeri që unë Metush Krasniqin e kom pasë, nuk thom idol, po e kom respektu ma s'shumti se ka qenë vizionar edhe e kom dashtë. Mirëpo njeriun nuk e kom bo t'shejtë, tash qysh po i bojnë t'shejtë. E bonën Ibrahim Rugovën të shejtë, t'cilin e kom njoftë, kom fotografi me të e krejt. E bon të shejtë. Tash edhe Albinin e bonën të shejtë që nuk osht' i shejtë.

Ju kom thanë, "Lenja historisë historia nesër ka"... unë s'kom besim. E kom thanë haptas. Se kom fakte që s'kom besim n'të po mos e boni t'shejtë. Nuk bon me bo dikanin njeriun me ba hyjni, nuk bon me ba hyjni. Ka gabime. S'ka njeri që s'ka gabime. Mirëpo thojnë çdo gabim përmirësohet veç tradhëtia kurrë s'përmirësohet. Kurrë tradhëtia. Kanga e Bajram Currit qe 100 e sa vjet, 'O Kadri, Kadri Mehmeti, pa besë e tradhëtar'. Domethonë çdo gabim përmirësohet, tradhëtia s'përmirësohet. Qita që kanë bo tradhëti edhe që po bojnë tradhëti populli ka m'i dënue. Populli ka m'i dënue.

Tradhëtia s'përmirësohet kurrë. Pamarrë parasysh kush osht'. Popullin s'munësh me tradhëtue, e tradhëton niherë, dy. E keqja jonë ma e madhe osht' Muharrem Musliu po flet mirë, qenka burrë i mirë. Po kqyri veprat e mija çka po veproj, qato, në bazë t'qatyne veprave. Ka pasë aty burra t'mirë, p'e za në Shërbim të Kontabilitetit që thojsh ky as s'ish punëtor i mirë, as s'ish prind i mirë, as kurgjo. Pse kurrë

s'folke po rrijke si zotni. Kqyrja veprat, kqyrja sjelljet, qato se jo n'bazë t'fjalëve. A foli Muharremi mirë, te osht' burrë i mirë, po çfarë, kqyrmi veprat për shembull. Qito gjana janë vajza e mirë.

Kom folë ashtu çka po i mbaj mend ende që i kom përjetue, që vet i kom përjetue edhe që i kom analizue. T'cilat kom qenë dëshmitar i të gjitha qityne ngjarjeve kom qenë dëshmitar. I '57-tes e '58-tes, e '64-tes momentalisht kom qenë ushtar, e '68-tes po kom qenë i kyçur edhe '75-tes tregova haptas krejt. Ademi gati ni vit t'plot ka nejtë në shtëpinë time me Ahmet Haxhinë. Që harrova me cekë. 1969-ten... si e përmenda këtë Ahmet Haxhinë është gjyshi i Albulenës.

Shkon në Gjakovë te Din Spahiu edhe e qet në Shqipni. Kta pak, krejt pak e dijnë. E kom thanë ni ditë kur i vdiq ni djalë Ahmet Haxhisë, i thashë në Grand e majtën t'panën isha me familje, me tre vllazën edhe ishim me tri gratë. E kthejnë të Shqipnisë. Se Din Spahiu është ni shok i jonë i Gjakovës e qet'. E kthejnë i thojnë, "Ti je ma i nevojshëm në Kosovë sesa në Shqipëri". Çka ish e vërtetë. U pa viteve të '90-ta masanej. Ka vdekë ai.

Isha unë te Hilmi Rakovica në Lagje të Muhaxherëve. Natën me 13 mars '59-tes ftoft, fërflazë. Po vjen, hyni mrena. "Ha Baca Ahmet", tha, "Valla kom ardhë prej Shqipërie", qishtu qishtu tha, "po du se mos po m'kërkon pushteti, po du", tha, "me m'çu te qiky vlla", te une, "bile nja ni muj ditë". Unë e kisha në Ulpianë te Hasan Prishtina banesën, 44 metra njëmbëdhjetë anëtarë të familjes. E marrë unë Ahmetin atë natë. Prej atyhit e shkojmë me Hilmiun te unë, ni muj ditë. Familja s'e dishin kush osht' hiç (qeshë). Nuk ju tregojsa se s'dojsha me ditë.

Mas ni muj dite vjen Ramadan Haziri qiky shoku im që ka vdekë para pesë viteve, një prej shokëve ma t'ngushtë të jetës. Hyjmë në kuzhinë aty, i kisha dy fmi atëherë edhe nanën e vllaznit e motrat. Po shkoj po i thom, "Baca Ahmet", ai ish n'dhomë, thashë, "Dani ka ardhë ktu", tha, "Ani". Shkum me Danin, kur e ka pa Dani tha, "Muharrem ti ktu në këtë banesë p'e man, nuk bon hiç", tha, "po kem me marrë me çu", ai ishte, punonte arsimtar në shkollë në Prelez afër Ferizajit. "E mshefi", tha, "unë n'shkollë". Ka qenë shumë interesant. Çohemi natën, Ramadan Haziri, mocanik i imi, Ahmet Haxhija, Metush Krasniqi, Hyrije Hana, unë drejt në Ferizaj n'kamë.

**Anita Susuri:** N'kamë?

**Muharrem Musliu:** N'kamë natën se jo ditën, natën. Kjo osht' '59-shin, natën. Kur e shifshim që po kalon naj veturë, hishim, a din, që mos me na pa rrugës. Kur kemi shku në mëngjes atje t'lodhur. Hyrija u rruzu, meniherë u rruzu. Gjithë natën t'u udhëtue. Kemi sakrifiku pa kurgjo hiç. Nja ni muj ditë rrin aty. E ka mshef, strehim në shkollë aty. Mas ni muj dite çohet Shaipi, vllau im rrobaqepësi, e merr këtë Zeqir Gërvallën e shkojnë e marrin.

Prej atyhit e çojnë në Dajkovc te Baca Metush, te Metush Krasniqi. Ni muj ditë. Mas tre mujve s'e kërkoj kërkush edhe dul lirisht masanej (qeshë). Ka qenë shumë interesant. Në atë kohë '69-shen me majtë ti njeriun që e kërkon pushteti, rrallta familje kanë qenë. Veç na që kemi rrezikue njëni për tjetrin.

Kur hyna unë n'dhomë po m'thotë ai magjupi po m'thotë, "Kqyr naltë", kur po kqyri ata telat me t'vërtetë... ju thashë, nuk i besojsha ktij thojsha, "Ma ka shti kta hetuesit me qëllim diçka me zbulue". Tha, "Jo, kanë ikë e kanë pre. Na kemi qenë jashtë edhe ka ra shi atë nate". Ka qenë m'duket ni Kamer, Kamer Hoxha gardien naltë atje. Mirëpo kur vjen shi mbi burg janë ato teneqet edhe shiu kërset pak, a din, rropllon ose qysh thojnë e lshon nifar' krisme. Aty qysh m'ka tregu ky, qysh m'ka tregu ky magjupi edhe ka qenë ni i Kaçanikut për vrasje...

**Anita Susuri:** Po, Ilaz Dardhishta a nuk e di...

**Muharrem Musliu:** Nuk e di, a din pse s'e di, tash të tregoj. "Kur ka ikë ky i pari i pari", tha, që nuk ia dijkë emrin që ma tregonte me emër me mbiemër. Tha, "Ka ikë ka dalë aty përpjetë e tash kur ka hy ky i kaçanikasi ka kërset me durë edhe gardiani e ka dëgjue edhe ka ardhë e kanë zanë. Ende pa dalë. Gjysën e trupit, gjysën e ka pasë n'dhomë", qysh m'tregonte ky, tash sa osht' e vërtetë. Ky magjupi qysh m'tregonte. "E kanë marrë", tha, "edhe ia kanë dhanë nja dy-tre grushta".

Tash p'e di që e kanë zanë, p'e di që e kanë marrë se kur më morën mu që m'qitën prej treshit që ishte poshtë, ata e kanë pru aty. E mu m'çun naltë. Domethonë kjo osht' 100% që e kanë zanë. Ai për vrasje, ka vra djalin e axhës t'vet. Ndoshta ju kanë tregue e dini rastin.

**Anita Susuri:** Po, po. Ka qenë 15 vjet i dënun ai po m'duket.

**Muharrem Musliu:** Po. P'e dini rastin pse e ka vra?

**Anita Susuri:** Jo.

**Muharrem Musliu:** Po s'osht' me randësi. Se mu edhe m'ka tregu edhe gjykatësi. Tash t'nesrit, Vesel Laitifi, profesori që ka dhanë n'fakultet, tash ka ndrru jetë para nja dy-tre muj dite. Ka qenë ministër atë kohë që thojshin për jurispodencë, për drejtësi. Masi osht' thye burgun u dashtë me inspektue burgun. E kish pasë ni serbe, e kish pasë asistente, ni serbe. Tash kur shkon e pytë aty, "Kush osht' n'këtë dhomë 26", thojnë, "Muharrem Musliu", e nuk hyn se unë Veselin shok, Vesel Latifin.

Ai ka qenë ni gjeneratë mas meje në gjimnaz. Po edhe kemi pasë far' shoqnie. E shtin veç atë asistenten e vet, ni serbe. Tash kur hyni ajo po pytë thashë, "Mu", thashë, "tash m'kanë pru, natën m'kanë pru". Tash p'e pytë atë magjupin, tha, "Nuk e di, unë kom qenë na kemi qenë në shëtitje kur kemi ardhë", tha, "e kemi gjetë t'pren aty, ata telat e pren për me ikë", unë qikaq di. A e di që mu

m'kanë çu, prej treshit m'kanë çu në 26. E qita të Kaçanikut e kanë marrë e kanë çu në tresh atje poshtë.

Tash kur dola mas katër-pesë vjete po takohna me Veselin. Tha, “Jo valla, s'kom guxu me hy aty”, “Pse?” Thashë, “T'kisha pytë për çka je? Ti kishe thanë për kurgjo”, (qeshë). Tha, “Çka me bisedu me ty”, tha, “e shtina atë sekretareshën”...

**Anita Susuri:** A keni vrejtë ju për shembull, a ka ndodhë pastaj...

**Muharrem Musliu:** E prun ata ni rrjetë, e prun ni rrjetë aty e prun ni rrjetë te na tri fijesh, diçka tri fijesh e prun ni rrjetë. Se unë atje në tresh nuk shisha kurgjo veç ka qenë ni, ni, ni llampë ka qenë në tresh poshtë. 24 orë ajo ka qenë, se s'ka pasë xhama kërkund treshi ku kom nejtë 34 ditë n'dhe atje poshtë. S'ka pasë xhama. S'ka pasë dritaren. E ka pasë veç ni llampë që mrena atje n'mur që bojke dritë aty. Kjo e kish pasë aty.

Tash kesh unë mas, kur u lshu si muze. Bile ke kjo ministrja ke Vlora Dumoshi, vajza e Ismail Dumoshit. Po m'kap e po m'përqafon a din, “Axha Muharrem”. Thashë, “Po, qitu në tresh”. Jeta Xharra tha, “Po du me bo ni intervistë”, s'pranova. Edhe ty me t'pasë ngjofhtë mirë nashta edhe te ti s'isha ardhë (qeshë). Se nuk i jepi gjithkuj intervistë, nuk du me keqpërdorë.

**Anita Susuri:** Zoti Muharrem, desha me ju falënderu shumë edhe për kontributin edhe kohën për intervistën që na keni dhanë, faleminderit shumë edhe njëherë!

**Muharrem Musliu:** Qy vajzë e mirë, ka qenë edhe privilegj për mue sado pak me tregue një çashtje tonë kombëtare që kom qenë edhe unë ni pjesë e një mijta, e ni milianta pjesë e qisaj çashtje që e kemi mbajtë qat' un gjallë prej viteve 1878 prej Lidhjes së Prizrenit edhe këndej. Kurrë nuk u shym, kurrë nuk u shym edhe sot nuk shymet. Edhe sot ka njerëz që me t'vërtetë punojnë në mënyrë legale, jo mënyrë ilegale po mënyrë legale për bashkim kombëtar, për t'cilin prej se di për veti kom qenë për bashkim kombëtar.

Kjo osht' që thojnë dhunti e zotit që na ka falë neve shqiptarëve bashkë, që do t'jetojmë bashkë, që do ta kemi ni shtet të përbashkët. Kta s'ka me mujtë kërkush me ndalë, kurrë hiç s'ka me mujtë. Po a sot, a nesër, a masnesër... edhe pa marrë parasysh kush e bon këtë bashkim kisha me përqafue, pa marrë parasysh kush. Se s'më intereson çashtja ideologjike mirëpo mu m'intereson vetëm çashtja kombëtare. S'kom qenë i lidhur kurrë me ideologji edhe s'jom.

M'vjen keq do t'ri që ende i kanë ose do analista, do analista që dojnë me formue ni komb kosovar. Që kjo është luftë e përhershme e serbëve për diçka të tillë, me na nda neve kosovarëve, shqiptarëve të Kosovës. Se neve deri vonë, deri vitet e '70-ta na kanë thanë, 'Shiptari', shqiptarë. Kur kemi dalë jashtë për shembull, kanë thanë, 'Shiptari'. Janë habitë në Francë kur ka shku “Shota” në Francë atje me lujtë



valle e krejt i kanë paraqit, “Shiptari sa juga Jugosllavije, Shqiptartë e jugut të Jugosllavisë”. Janë habitë kah lindi ky komb shqiptarë. Janë habitë. Se t’kishin thanë ‘Albanski’, albaneze, kishte me qenë ndryshe po ‘Shiptar’. Domethonë janë habitë kah lindi ni komb shqiptarë.

E po i shoh do Halil Kadosha, do Halil Matosha, do, ky Spahiu i Mitrovicës, ai Nexhmedin Spahiu e do tjerë, kombi kosovar. Ka lindi? Kto janë shumë t’rrezikshme, osht’ e rrezikshme edhe vehabizmi te na. Shumë është i rrezikshëm. Ky është ma i rrezikshëm se të gjithë të tjerët. Mirëpo ma merr menja që qysh kemi jetu qe dy mijë vjet Kosova s’ka pasë shtet, sot u bom shtet. A osht’... se për histori kurgjo s’janë një mijë vjet, 100 vjet. Kjo osht’ dhunti e zotit. Zoti ka me na bashkue t’gjithve, kem me qenë bashkë me jetue, ndoshta me kojshi tonë pa marrë parasysh çka na kanë ba, çka na kanë ba. Mirëpo kur t’bohemi tub, kur t’bohemi bashkë çka me na ba.

Faleminderit edhe prej jush! Ka gjana që ka pasë ende me thanë po ndoshta s’i kom pa të arsyeshme apo i kom harrue, s’duhet me ma pa për t’madhe. Se në moshë të shtyne, në moshën gati 84 vjet. Jom mundu me qenë fer, korrekt, pa kurfar’ lavdimi e qishtu. Faleminderit prej jush!

**Anita Susuri:** Faleminderit! Ishte knaqësi!